



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport përfundimtar i auditimit të ushtruar në Fakultetin e Ekonomisë**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**“AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE”**

**TIRANË 2025**

## **Përmbajtja**

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	3
1.	1 Përshkrim i shkurtër.....	3
	a. Përshkrim i shkurtër.....	3
	b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij. ....	3
	c. Qëllimi i auditimit: .....	3
	d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave. ....	3
	e. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore; .....	4
	f. Gjetjet kryesore:.....	4
	g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.....	5
1.2.	Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit. ....	5
II.	HYRJE.....	7
	1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.....	7
	2. Identifikimi i çështjes: .....	7
	3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar: .....	8
	4 Përgjegjësia e audituesve të KLSH: .....	8
	5. Kriteret e vlerësimit:.....	8
	6. Standardet e auditimit.....	9
	7. Metodot e auditimit .....	9
	8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:.....	10
III.	PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.....	11
	1. Informacion i përgjithshëm .....	11
	2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT .....	11
	2.1 Auditim mbi hartimin dhe zbatimin në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe në mbështetje të aktiviteteve të parashikuara në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” .....	11
	2.2 Auditim i zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave .....	17
	2.3 Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....	22
	2.4 Auditim i llogarive vjetore .....	25
	2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, shërbimeve dhe mallrave .....	44
	2.6 Vlerësimi i funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar .....	52
	2.7 Vlerësimi i komponentëve të auditimit të brendshëm .....	55
III.	GJETJE DHE REKOMANDIME.....	55
	A. MASA ORGANIZATIVE.....	55

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1. 1 Përshkrim i shkurtër.

#### a. Përshkrim i shkurtër

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 103/27 prot., datë 27.12.2024, i ndryshuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Fakultetin e Ekonomisë (FE), për periudhën 01.01.2021 deri me datën 31.12.2024, u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë dhe rregullshmërinë e operacioneve financiare të kryera nga ana e këtij institucioni, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me llogaridhënien vjetore, administrimin e fondeve buxhetore dhe zbatimin e procedurave të emërimit dhe largimit nga puna të arsimtarëve, aspektet e menaxhimit financiar dhe të vlerësimit të sistemeve të kontrollit, etj.

#### b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të FE për periudhën e aktivitetit 2021-2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor, që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore, ku FE është subjekt i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron dhe fakti se ky institucion nuk ishte audituar nga KLSH-ja për një periudhë mbi 5 vjet.

#### c. Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i këtij auditimi ishte dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën e auditimit nga data 01.01.2021 deri ne 31.12.2024.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Auditimi mbi hartimin dhe zbatimin në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe në mbështetje të aktiviteteve të parashikuara në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;*
- *Auditim i zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave;*
- *Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare;*
- *Auditim i llogarive vjetore;*
- *Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, shërbimeve dhe mallrave;*
- *Vlerësim i funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar;*
- *Vlerësimi i komponentëve të auditimit të brendshëm.*

#### d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave.

Metoda e përdorur ka qenë auditimi i njëpasnjëshëm dhe përzgjedhja e periudhave specifike.

Qasja audituese e Kontrollit të Lartë të Shtetit përfaqëson një metodologji të mbështetur në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në subjektin e audituar. Kjo qasje mundëson realizimin e auditimit në mënyrë eficiente dhe efektive, me fokus te natyra, koha dhe shtrirja e procedurave audituese në fushat me rëndësi materiale dhe risk të lartë.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, është bërë përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve. Zgjedhja i transaksioneve të kryera përgjatë vitit 2022 dhe vitit 2023, është bërë bazuar në ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit” dhe ISSAI 1530 “Shënime praktike mbi ISA 530”.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 13,940 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve. Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: *Kontrolli aritmetik, Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët, Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.*

#### **e. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore;**

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se, Fakulteti i Ekonomisë për periudhën nën auditimit paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar 13 masa organizative dhe janë lënë 12 rekomandime. Në vijim paraqiten ato më kryesoret:

#### **f. Gjetjet kryesore:**

Nga auditimi financiar dhe përputhshmërisë në Fakultetin e Ekonomisë gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

- Nga auditimi i procedurave me vlerë të vogël për periudhën objekt auditimi, rezultoi se, në 5 (pesë) procedura përlllogaritja e fondit limit nuk është bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet, dhe për 3 (tre) procedura, shërbimi ka filluar realizimin e tij dhe është bërë marrja në dorëzim nga grupi i ngritur nga titullari i AK para realizimit me sukses në SPE të procedurës;

- Nga auditimi me përzgjedhje i urdhër shpenzimeve lidhur me pagesat e personelit akademik me kohë të pjesshme, u konstatua se deklarimi i punonjësve/stafit në organet tatimore bëhej në momentin e likuidimit në fund të periudhës mësimore;

- Nga auditimi i shpenzimet për mallra dhe shërbime për vitin 2024 në nënlllogarinë 6029 “Shpenzime të tjera operative” konstatohen keqklasifikime si:

Shpenzimet për grupin e punës për pjesëmarrjen në komisionin e përhershëm të dhënies së gradës "Doktor" në shumën 367,984 lekë vlerë e cila duhet të ishte kontabilizuar në nënlllogarinë 6009 “Shpenzime të tjera për personelin”.

Shpenzimet “Pagesë për shërbime blerje antivirus, për Fakultetin e Ekonomisë” në shumën 119,724 lekë, vlerë e cila duhet të ishte kontabilizuar në llogarinë 203 “Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme”.

Gjithashtu nga auditimi i shpenzimeve për “Blerje mallra e shërbime” u konstatua keqklasifikime brenda nënlllogarive të kësaj klase, duke sjellë një denatyrim të shpenzimeve për mallra dhe shërbime.

### **g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.**

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Administratori i Fakultetit Ekonomik të marrë masat e nevojshme në hartimin e fondit limit, specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve në përputhje me tipologjinë e objektit që prokurohet;
- Sektori i Financës të marrë masa për deklarimin e punonjësve/stafit në organet tatimore, një ditë përpara fillimit të ofrimit të shërbimit nga ana e punonjësve/stafit, si dhe të bëhet trajnimi i stafit lidhur me ndryshimet ligjore sa i përket legjislacionit të marrëdhënieve të punës;
- Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi për të pasqyruar saktë shpenzimet e kryera sipas rregullave kontabël, natyrës së shpenzimeve, klasifikimit të saktë të tyre me qëllim paraqitjen e drejtë në pasqyrat financiare.

### **1.2. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.**

#### **Opinioni për auditimin financiar, i kualifikuar<sup>1</sup>**

Ne kemi audituar hartimin dhe konsolidimin e pasqyrave financiare të të Fakultetit Ekonomisë për periudhën e mbyllur 31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

#### **Opinioni:**

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2024, referuar kuadrit rregullator në fuqi:

Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, etj.

#### **Baza për opinionin:**

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t.

Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 13,940 mijë lekë, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një “Opinionit të pamodifikuar” të auditimit.

<sup>1</sup> -Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar “ të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (faqe 54 dhe 60-61), “Një “Opinion i Kualifikuar”, jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.*”

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

-Nga auditimi i llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”; 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” dhe 218 “*Inventar ekonomik*” u konstatua se metoda e llogaritjes së amortizimit vjetor është me “Vlerë të mbetur”, si dhe norma amortizimi për periudhën objekt auditimi është e ndryshme nga viti në vit dhe jo sipas përcaktimeve të pikës 36 të Udhëzimit, përkatësisht:

Për llogarinë 212 është aplikuar 2%, dhe jo 5%; për llogarinë 214 norma e amortizimi është aplikuar 12% për vitet 2021 dhe 2022 dhe 25% për vitin 2023 dhe 2024, si dhe për llogarinë 218 është aplikuar norma 5% për vitet 2021 dhe 2022.

Nga auditimi i të ardhurat dytësore të pasqyruara në pasqyrën e performancës u konstatua se ka mospërputhje me të dhënat e thesarit në lidhje me këto të ardhura, konkretisht: Për vitin 2024 kemi një mospërputhje në shumën 51,499,306 lekë, për vitin 2023 kemi një mospërputhje në shumën 23,845,458 lekë dhe për vitin 2022 kemi një mospërputhje në shumën 77,109,771 lekë, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të strukturës së të ardhurave.

Nga auditimi i shpenzimet për mallra dhe shërbime për vitin 2024 në nënlllogarinë 6029 “Shpenzime të tjera operative” konstatohen keqklasifikime si:

- Shpenzimet për grupin e punës për pjesëmarrjen në komisionin e përhershëm të dhënies së gradës "Doktor" në shumën 367,984 lekë vlerë e cila duhet të ishte kontabilizuar në nënlllogarinë 6009 “Shpenzime të tjera për personelin”.

- Shpenzimet “Pagesë për shërbime blerje antivirus, për Fakultetin e Ekonomisë” në shumën 119,724 lekë, vlerë e cila duhet të ishte kontabilizuar në llogarinë 203 “Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme”. Gjithashtu nga auditimi i shpenzimeve për “Blerje mallra e shërbime” u konstatua keqklasifikime brenda nënllogarive të kësaj klase, duke sjellë një denatyrim të shpenzimeve për mallra dhe shërbime.

### **Opinion mbi përputhshmërinë: (I pamodifikuar)**

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Fakultetit të Ekonomisë, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat dhe rregulloret që lidhen me procedurat e prokurimit, zbatimin e kontratave, veprimeve me bankën, etj.

Në opinionin tonë, bazuar në punën e kryer të auditimit, në tërësi ka rezultuar se aktiviteti i Fakultetit të Ekonomisë, është në përputhje me të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor dhe rregulloret e zbatueshme në fushat e prokurimit publik, nëpunësit civil, menaxhimit financiar e kontrollit, etj. Ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pamodifikuar** mbi përputhshmërinë.

### **Baza për opinionin e përputhshmërisë<sup>2</sup>**

Ne kemi kryer auditimin e përputhshmërisë në mbështetje me Ligjin nr.154/2014, miratuar në datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në

<sup>2</sup> Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 245, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit të përputhshmërisë”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.102), Kapitulli VII, pika 7.3.3: “Opinionin i pa modifikuar/ i pa kualifikuar: Kur nuk janë gjetur apo konstatuar raste të mospërputhjeve materiale në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, audituesi shpreh opinion të pamodifikuar ose të pakualifikuar që informacioni i përgatitur, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e aplikueshme.”.

përputhje me ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin nr. 217, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga FE dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidencat e auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit ***të pamodifikuar***.

## **II. HYRJE**

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 103/27 prot., datë 27.12.2024, i ndryshuar, nga data 06.01.2025 deri më datë 11.04.2025, në Fakultetin e Ekonomisë, u krye auditimi në të nxehtë, financiar dhe përputhshmërie për periudhën nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2024, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. K., Përgjegjës grupi
2. A. C., Anëtar
3. A. R., Anëtar

### **1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit**

Objekt i këtij auditimi është auditimi përputhshmërie dhe financiar, ku do të përcaktohet niveli i zbatimit të kriterëve të vlerësimit, referuar kuadrit rregullator. Ky auditim ka si qëllim:

- Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.
- Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

***Qëllimi i auditimit:*** Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

### **2. Identifikimi i çështjes:**

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të Fakultetit të Ekonomisë, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi, fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së FE-së, në përputhje me aktet ligjore, të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përkatëse të FE-së.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e riskut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë e Fakultetit të Ekonomisë.

### **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:**

Strukturat drejtuese të fakultetit, janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për përdorimin e burimeve financiare me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për fushat e veprimtarisë së FE-së, në drejtim të mirë administrimit të fondeve.

### **4 Përgjegjësia e audituesve të KLSH:**

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e FE-së është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH-së kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, paragrafi 44-51.

### **5. Kriteret e vlerësimit:**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”;

- Ligji nr. 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”;

- Ligji nr. 84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”;

- Ligji nr. 97/2023, datë 07.12.2023 “Për buxhetin e vitit 2024”;

- Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;

- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

- Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”;

- Statuti i Universitetit të Tiranës miratuar me urdhrin e Ministrit të Arsimit nr.816 datë 26.12.2018;
- VKM-së nr.656 datë 31.10.20218 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore” i ndryshuar, (me VKM nr. 559 datë 31.07.2019 e VKM nr.612 datë 29.07.2020);
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm”; Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar;
- Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”;
- Udhëzimit nr. 5 datë 25.06.2021 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

## 6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

## 7. Metodatat e auditimit

Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficiencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampionëve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

- *Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit<sup>3</sup>. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e*

<sup>3</sup> ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar;

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve);

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”;

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt;

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre;

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër;

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.;

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre;

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet;

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim;

- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

## **8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:**

Audituesit e KLSH-së, mbi bazën e evidencave dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me stafin, kanë mbledhur dhe shqyrtuar dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të

kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, intervistave etj., të finalizuara me akt-konstatimet, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Auditimi. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e mbledhura gjatë auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të akt-konstatimeve, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

### **III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT**

#### **1. Informacion i përgjithshëm**

Fakulteti Ekonomik është njësi kryesore përbërëse e Universitetit të Tiranës, sipas Statutit të Universitetit të Tiranës 2018, neni 11 dhe e mbështet veprimtarinë në Ligjin 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”, në aktet nënligjore në fuqi, në Statutin e Universitetit të Tiranës, në Rregulloren e UT dhe në Rregulloren e Fakultetit. Financimi i aktivitetit të FE-UT-së, sipas Ligjit nr.80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 109, ka burimet si më poshtë:

- a. *Buxheti i Shtetit (në formën e grantit sipas kategorive: i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, i mësimdhënies, i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese);*
- b. *Pagesat e Studentëve për arsimim;*
- c. *Të ardhura për shërbimet e kryera;*
- d. *Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;*
- e. *Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi;*
- f. *Veprimtari kërkimore-shkencore.*

#### **2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.**

##### **2.1 Auditim mbi hartimin dhe zbatimin në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe në mbështetje të aktiviteteve të parashikuara në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”**

##### **1. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës**

Financimi i Fakultetit të Ekonomisë si Njësi Ekonomike, në zbatim të nenit 109 të Ligjit nr.80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kryhet si më poshtë:

- Për shpenzimet për paga, sigurime, mallra dhe shërbime (llog 600, llog 601, llog 602, 606);
  - Për shpenzimet për investime (llog 230 & llog 231).
- a. *Buxheti i Shtetit (në formën e grantit sipas kategorive: i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, i mësimdhënies, dhe veprimtarive krijuese);*
  - b. *Pagesat e Studentëve për arsimim;*
  - c. *Të ardhura për shërbimet e kryera;*
  - d. *Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;*

e. Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi.

### 1.1 Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të MF

#### - Projekt Buxheti Afatmesëm 2021-2023, 2024-2026

Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore e Universitetit të Tiranës dërgon materialin përgatitor për miratimin e PBA-së drejt UT-së, brenda afateve të përcaktuara në shkresën e kërkesës, në formë shkresore dhe elektronike. PBA miratohet në formë paraprake nga Senati dhe në formë përfundimtare nga Bordi i UT-së. Më pas UT i përcjell Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve PBA-në përmbledhëse për të gjitha njësitë.

Për aktivitetin e vitit 2021, me shkresën nr. 27/2 prot, datë 05.02.2021, Administratori i FE-UT i përcjell Universitetit të Tiranës planin për vitin 2021, ku pas miratimit UT me shkresën nr. 122/12 prot. Datë 12.04.2021, i dërgon FE-UT buxhetin e miratuar për vitin 2021.

Për aktivitetin e vitit 2022, me shkresën nr. 276 prot, datë 28.2.2022, Administratori i FE-UT i përcjell Universitetit të Tiranës planin për vitin 2022, ku pas miratimit UT me shkresën nr. 476 prot, datë 11.4.2022, i dërgon FE-UT buxhetin e miratuar për vitin 2022.

Për aktivitetin e vitit 2023, me shkresën nr. 239/1 prot, datë 14.2.2023, Administratori i FE-UT i përcjell Universitetit të Tiranës planin për vitin 2023, ku pas miratimit UT me shkresën nr. 623 prot, datë 18.4.2023, i dërgon FE-UT buxhetin e miratuar për vitin 2023.

Për aktivitetin e vitit 2024, me shkresën nr. 150 prot, datë 31.01.2024, Administratori i FE-UT-së i përcjell Universitetit të Tiranës planin për vitin 2024, ku pas miratimit UT me shkresën nr. 635/5 prot, datë 26.03.2024, i dërgon FE-UT-së buxhetin e miratuar për vitin 2024.

#### Projekt Buxheti Afatmesëm

Nr.	Emërtimi	Viti 2022-2024		Viti 2023-2025		Viti 2024-2026	
		Programuar	Çelur	Programuar	Çelur	Programuar	Çelur
1	Paga, art. (600)	257,890,000	242,173,961	269,981,000	228,550,931	278,182,000	258,553,622
2	Sigurimet shoq. dhe shen., art. (601)	42,086,000	49,748,140	41,983,000	49,108,781	43,287,000	50,448,122
3	Shpenzimet operative, art. (602)	103,000,000	477,000	103,975,000	80,815,000	0	0
4	Bursa për studentët, art. (606)	130,000,000	93,830,340	130,000,000	108,851,000	117,000,000	103,441,341
5	Investime, art. (231)	255,000,000	0	255,000,000	0	172,000,000	0

**Burimi:** FEUT, përpunuar nga grupi i auditimit

#### Konkluzion:

Sipas të dhënave të grumbulluara nga PBA e FEUT-së 2021-2024, krahasuar me buxhetin e miratuar për vitet 2021, 2022, 2023, 2024 në të gjitha llogaritë ka një diferencë. Për llogarinë 231 “Investime” në PBA është miratuar vlera 255,000,000 lekë për 2021 dhe 2022 dhe 172,000,000 lekë për vitin 2023 ndërkohë që në buxhetin e viteve përkatëse vlerë është 0 për FEUT. Llogaria Zëri Paga, në llogarinë 600, për vitin 2021 është programuar 257,890,000 lekë dhe çelur 242,173,961 lekë, për vitin 2022 programuar 269,981,000 lekë dhe çelur 228,550,931 lekë!

Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të MF-së.

Referuar Ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, Neni 52 “Funksionet e Administratorit”, pika 1/c, ku

shprehet se: 1. Administratori kryen këto funksione: c) ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit të arsimit të lartë në strukturat e varësisë së tij”.

Më poshtë paraqiten të dhënat e zbatimit vjetor të buxhetit në FE-UT përgjatë periudhës së auditimit 2021-2023 dhe 2024:

*Zbatimi vjetor i buxhetit për vitet 2021-2023 (në lekë)*

Nr.	Emërtimi	Viti 2021			Viti 2022			Viti 2023		
		Plan	Fakt	Realizimi në %	Plan	Fakt	Realizimi në %	Plan	Fakt	Realizimi në %
1	Paga, art. (600)	242,173,961	241,782,000	99	228,550,000	228,550,000	100	258,553,622	293,087,300	113
2	Sigurimet shoq. dhe shëndetësi. art. (601)	49,748,140	39,748,000	79	49,108,781	46,860,000	95	50,448,122	45,929,221	91
3	Shpenzimet operative. Art. (602)	477,000		0	80,815,000	49,865,000	61			
4	Bursa për studentët, art. (606)+trf tjera	93,830,340	114,740,000	122	108,851,000	105,729,000	97	103,441,341	101,286,0	97
5	Investime, art. (230)	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6	Investime, art. (231)	0	0	0	0	0	0	0	0	0

*Burimi: FEUT Përpunuar nga Grupi i Auditimit të KLSH*

*Zbatimi vjetor i buxhetit për vitin 2024 (në lekë)*

Nr	Emërtimi	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Realizimi në %
		2024 Kapitulli 8	2024 Kapitulli 8	2024 Kapitulli 6	2024 Kapitulli 6	
<b>I</b>	<b>Shpenzime personeli</b>	<b>382,774,000</b>	<b>382,656,000</b>	<b>172,747,000</b>	<b>171,383,000</b>	
1	Paga ,llogaria 600	329,480,902	329,409,000	158,854,000	158,854,000	100%
2	Sigurime Shoqërore, llogaria 601	51,842,988	53,294,000	13,893,000	12,529,000	92%
<b>II</b>	<b>Mallra dhe shërbime të tjera (llogaria 602)</b>			<b>98,064,351</b>	<b>66,126,000</b>	
1	Mallra dhe shërbime të tjera	477,000		48,429,000	19,569,000	40%
2	Transferta te Buxhetet Familjare dhe Individët (llogaria 606)			111,386,000	93,198,000	82%
<b>III</b>	<b>Shpenzime për investime(230,231)</b>			<b>823,000</b>	<b>0</b>	<b>0%</b>
1	Investime për pajisje elektrike, IT, industriale dhe mobilime					
2	Investime në projekte dhe rikonstruksione					
	<b>TOTAL (I)+(II)+(III)</b>					

*Burimi: FEUT Përpunuar nga Grupi i Auditimit të KLSH*

Planifikimi i fondeve të hartuar nga FEUT, për Buxhetin e vitit 2024 krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2023), paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

**Krahasimi Buxhetit**

Nr	Emërtimi	Fakt	Fakt	Plani	Plani	Fakti	Fakti
		2023 Kapitulli 8	2023 Kapitulli 6	2024 Kapitulli 8	2024 Kapitulli 6	2024 Kapitulli 8	2024 Kapitulli 6
<b>I</b>	<b>Shpenzime personeli</b>	<b>339,016,521</b>	<b>142,894,971</b>	<b>382,774,000</b>	<b>172,747,000</b>	<b>382,656,000</b>	<b>171,383,000</b>
1	Paga ,llogaria 600	293,087,300	130,896,589	322,041,902	158,854,000	329,480,000	158,854,000
2	Sigurime Shoqërore, llogaria 601	45,929,221	11,998,382	51,842,988	13,893,000	53,294,000	12,529,000
<b>II</b>	<b>Mallra dhe shërbime të tjera (llogaria 602)</b>		<b>36,320,000</b>		<b>98,064,351</b>		<b>66,126,000</b>
1	Mallra dhe shërbime të tjera			477,000	48,429,000		19,569,000
2	Transferta te Buxhetet Familjare dhe Individët (llogaria 606)	101,286,000			111,386,000		93,198,000
<b>III</b>	<b>Shpenzime për investime(230,231)</b>				<b>823,000</b>		<b>0</b>
1	Investime për pajisje elektrike, IT, industriale dhe mobilime			0			0
2	Investime në projekte dhe rikonstruksione			0			0
	<b>TOTAL (I)+(II)+(III)</b>						

*Burimi: FEUT, Përpunuar nga grupi i auditimit*

## 1.2 Realizimi i planit të buxhetit

### Buxheti 2024

Parashikimi i Buxhetit për vitin 2024 për artikullin buxhetor **600 dhe 601** është mbështetur në :

- Ndryshimet e ndodhura në strukturën e FEUT-së, e cila mban të pandryshuar totalin e stafit akademik të brendshëm, por ka pakësuar me 5 punonjës stafin akademik me karakter administrativ si edhe ka rialokuar dhe 2 punonjës nga staf ndihmës akademik në personel administrativ.
- Ndryshimet në nivelin e pagave për stafin akademik edhe personelin ndihmës administrativ, bazuar në VKM e pagave.

Parashikimi i Buxhetit 2024 për artikullin buxhetor 602 është mbështetur në:

- Realizimin e të ardhurave nga tarifat e shkollimit, por sipas Raportit të Analizës së Buxhetit për vitin 2024 përgatitur nga vetë Njësia Shpenzuese FEUT, 96.7% e të ardhurave të grumbulluara kanë shkuar në masën 96,7% për mbulim pagash edhe sigurimesh.

- *Granti buxhetor për FEUT përgjatë periudhës së auditimit 2021-2023:*

Emërtimi	Granti buxhetor Kod programi 09450											
	Viti 2021				Viti 2022				Viti 2023			
	Grant fillestar për 2021	Grant i	Rialokime	Total Grant viti 2021	Grant fillestar i akorduar në vitin 2022	Grant i	Rialokime	Total Grant viti 2022	Grant i fillestar i akorduar në vitin	Grant i	Rialokime	Total Grant viti 2023
FEUT	385,752,441	0	21,100,001	406,852,442	382,525,052	0	3,985,460	382,525,052	411,733,085	0	39,004,479	453,051,564

*Burimi: FEUT, përpunuar nga grupi i auditimit*

Granti buxhetor i FE-UT sipas kod programi 09450, për vitin 2021 është vlerën 406,852,442 lekë, për vitin 2022 është në vlerën 382,525,052 lekë për vitin 2023 është në vlerën 453,051,564 lekë dhe për vitin 2024 është 449,793,890. Në të treja vitet, 2021-2023, nuk ka grant të trashëguar nga ai paraardhësi për FEUT, por ka rialokime.

### Konkluzion

Pas auditimit të realizimit të buxhetit (kapitulli 8), grupi i auditimit konstaton se në vitin 2021 ka një tejkalim me 22% të llogarisë 606 “Bursa”,. Llogaria 602 “Shpenzime Operative” është realizuar në masën 61% në vitin 2022 dhe vetëm 40% në vitin 2024. Gjithashtu në të tre vite objekt auditimi janë të pranishme rialokimet, respektivisht në vitin 2021 gjenden në vlerën 21,100,001 lekë, në vitin 2022 në vlerë 3,985,460 lekë dhe në vitin 2023 në vlerë 39,004,479 lekë.

Këto rezultate nuk shkojnë në konformitet me Ligjin nr.57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9963 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 3, pika 29, konkretisht: *Objektiva të politikës së programit buxhetor janë rezultate specifike të matura saktësisht në kohë, sasi dhe kosto të cilat realizohen në një periudhë afatshkurtër deri afatmesme dhe që përbëjnë hapa të ndërmjetëm drejt arritjes së qëllimit të politikës së programit buxhetor.*

### 1.1 Realizimi i Planit të Buxhetit

➤ Realizimi i fondeve nga të ardhurat dytësore (Kapitulli 6) dhe shpenzimi faktik sipas viteve dhe zërave të shpenzimeve për Fakultetin Ekonomik:

në 000/lekë

Emërtimi	Viti 2021			Viti 2022			Viti 2023			Viti 2024		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	plan	Fakt	%
Paga, art. (600)	80,000	97,732	122	142,944	129,261	90	110,000	130,896	118	158,854	158,854	100%
Sigurimet shoq. Dhe shëndetësi. Art. (601)	0	5,694	-	0	920	-	10,000	11,998	120	13,893	12,529	92%
Shpenz. Operative (602)	83,900	38,981	46	90,982	23,880	26	105,866	54,329	51	48,429	19,569	40%
Investime, art. (230+231)	120,444	120,444	100	127,000	100,000	78	58,662	77,509	132	823	0	0%
<b>Total nga të ardhurat</b>	<b>284,344</b>	<b>262,851</b>	<b>92</b>	<b>360,926</b>	<b>254,061</b>	<b>70</b>	<b>284,528</b>	<b>274,732</b>	<b>96</b>	<b>186,382</b>	<b>224,319</b>	<b>127.4%</b>

*Burimi i të dhënave FEUT përpunuar nga Grupi i Auditimit*

Nga tabela e mëposhtme rezulton një realizim mesatar për zërat në masën 86%, ku zërat me përqindje më të ulët realizimi janë si më poshtë:

Artikulli 602 “Shpenzime Operative” në vitin 2021, 2022, 2023, 2024 ka përqindje realizimi të ulët me një realizim mesatar vjetor prej 41% ku përqindja më e lartë e mosrealizimit është vitit 2022, me vetëm 26%.

✓ Nga auditimi të evidencës së *planit të shpenzimeve operacionale për artikullin 602 nga të ardhurat dytësore, u rezultoi se:*

**Për vitin 2021:** Shpenzimet operative janë shpenzime që realizohen me anë të procedurave të prokurimit, të cilat nisin pas miratimit të buxhetit. Me shkresën nr. 122/12 prot, datë 12.04.2021, Universiteti i Tiranës i dërgon Fakultetit të Ekonomisë buxhetin e miratuar për vitin 2021. Në raportin e realizimit të Buxhetit Financiar që FE-UT i ka përcjellë Rektoratit 28.02.2022 thuhet se, procedurat e prokurimit kanë mangësi në realizim për shkak të periudhës së Covid-19, ndërkohë që një pjesë e procedurave të mbetura nuk kanë lidhje me situatën në vend në atë periudhë. Gjithashtu, duke qenë se Covid ishte aktiv në momentin e parashikimit të buxhetit, duhet të ishte marrë parasysh nga FEUT.

**Për vitin 2022:** Me shkresën datë 11.04.2022 Universiteti i Tiranës i përcjell FE-UT shkresën për miratimin e buxhetit dhe procedurat e prokurimit kanë nisur menjëherë pas kësaj shkrese. Në shkresën e datës 14.02.2023 nr. 239/1 prot, për realizimin e buxhetit financiar për vitin 2022 FE-UT shprehet se *nuk u realizua në pritshmëritë e planit për shkaqe objektive të cilat kanë të bëjnë me problematikën e vazhdueshme të shfaqur kryesisht nga procedurat e prokurimeve.*

**Për vitin 2023:** Me shkresën nr. 623 prot, datë 12.04.2023, Universiteti i Tiranës i përcjell FE-UT buxhetin e miratuar dhe pas kësaj nisin procedurat e prokurimit. Vihet re se në vitin 2023 janë realizuar 51% e prokurimeve, përqindja më e lartë nga të treja vitet, por përsëri me mangësi. Në Raportin për realizimin e buxhetit financiar të vitit 2023 datë 31.01.2024, nr. 151/1 prot, nuk shkruhet asgjë mbi arsyet e realizimit të ulët të kësaj llogarie.

Por ndërkohë në relacionin që shoqëron buxhetin faktik të vitit 2023, nga ana e vetë subjektit konsiderohet se realizimi në kohë i aktiviteteve si ëorkshop-e, konferenca, aktivitete të tjera studentore, panairë etj., ka ardhur për shkak të një planifikimi të saktë.

**Përsa i përket vitit 2024,** të ardhurat nga kapitulli 6, nga tarifat e studimit, të cilat përdoren për shpenzime të zërave të llogarisë 602, sipas Raportit për realizimin e buxhetit financiar të vitit 2024 datë 03.02.2025, nr. 199 prot, theksohet se ato janë përdorur thuajse krejtësisht për të mbuluar shpenzimet për paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërorë në masën 96.7% të tyre.

Bazuar në këto akte, të ardhura të trashëguara në vitin pasardhës janë:

Viti	FEUT		% e të ardhurave të trashëguara/vit ndaj të ardhurave /vit
	Të ardhurat totale nga FEUT	Të ardhura të trashëguara në vitin pasardhës	
2021	247,667,000	77,109,000	31%
2022	234,749,882	23,845,459	10%
2023	232,696,426	51,382,307	22%

### Konkluzion.

Nga auditimi rezultoi se në llogarinë 602 “Shpenzime Operative” në të gjitha vitet subjekt auditimi ka realizim të ulët, në masën 46%, 26%, 51% dhe 40%. Përqindja më e ulët e realizimit është në vitin 2022 ku 74% e të ardhurave nuk janë realizuar. Arsyet e dhëna nga ana e FEUT nuk e justifikojnë këtë problematikë. Problematika të tjera në përdorimin e të ardhurave reflektohen dhe në raportin e të ardhurave totale dhe atyre të trashëguara. Në vitin 2021 janë trashëguar 31% e të ardhurave në vlerën 77,109,000 lekë, në vitin 2022 10% e të ardhurave në vlerën 23,845,459 lekë dhe në vitin 2023 22% e të ardhurave në vlerën 51,382,307 lekë.

Kjo situatë nuk shkon në përputhje me Ligjin nr.80/2015, neni 118 Institucionet publike të pavarura të arsimit të lartë pika 5, konkretisht: *“IALPP-të nuk kanë qëllim fitimin dhe të ardhurat e përfituara nga veprimtaria dhe pasuritë e tyre përdoren për realizimin e misionit të institucionit”*. Shkaku i kësaj problematike është mungesa e një analize ekonomike të mirëfilltë për mënyrën e shfrytëzimit të fondeve që vijnë nga të ardhurat, me qëllim përmbushjen e të gjitha nevojave të institucionit. Efekti që ka është: *“Ngadalësimi i rritjes së cilësisë së shërbimeve të ofruara nga FEUT, duke mos shfrytëzuar të ardhurat në potencialin e tyre të plotë”*.

### 1.3 Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore

Auditimi mbi planifikimin, realizimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore të Fakultetit Ekonomik u krye mbi bazën e të ardhurave të Fakultetit të cilat burojnë nga tarifat e shkollimit dhe regjistrimit të studentëve, tarifa administrimi për vërtetime e konfirmime, dokumentacione, diploma, libreza etj. Të ardhurat përdoren tërësisht nga Universiteti i Tiranës bazuar në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 108, pika 3, konkretisht: *“Të gjitha të ardhurat e krijuara nga institucionet publike të arsimit të lartë përdoren prej tyre dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës”*. Përgjegjës për përcaktimin e rregullave për shpërndarjen e të ardhurave dhe mbikëqyrjen e përdorimit të burimeve të financimit është Bordi i Administrimit i cili për vitet e audituara ka nxjerrë vendimet si më poshtë:

**Për PBA:** PBA 2022-2024 është miratuar nga Bordi i Administrimit me vendim nr. 53, datë 26.11.2021; PBA për vitin 2023-2025 është miratuar nga Bordi i Administrimit me vendim nr. 50, datë 14.10.2022; PBA për vitin 2024-2026 është miratuar nga Bordi i Administrimit me vendim nr. 70, datë 19.12.2023.

**Për Buxhetin:** Vendimi i Bordit të Administrimit nr. 8, datë 06.04.2021; Vendimi i Bordit të Administrimit nr. 12, datë 08.04.2022; Vendimi i Bordit të Administrimit nr. 14, datë 11.04.2023.

### Të ardhurat e realizuara për FE-UT

Në lekë.

Viti	Parashikuar	Realizuar	Diferenca në %
2021	185,037,500	159,140,000	86%
2022	180,000,000	157,640,000	87%
2023	154,294,000	208,850,967	135%

2024	135,000,000	172,819,000	127.4%
------	-------------	-------------	--------

*Burimi i të dhënave FEUT, përpunuar nga grupi i auditit*

#### - Efekti financiar i studentëve debitorë

Nga auditimi i kryer në FEUT mbi studentët debitorë rezulton se për vitin akademik 2020-2021 efekti financiar i studentëve debitorë është 28,796,900 lek dhe numri i tyre gjithsej është 421. Numrin më të lartë të debitorëve e mban Cikli i Dytë Master Shkencor.

Për vitin akademik 2021-2022 efekti financiar i studentëve debitorë është 48,241,400 dhe numri gjithsej i debitorëve është 624.

Për vitin akademik 2022-2023 efekti financiar është 40,570,200 dhe numri i studentëve debitorë është gjithsej 655 studentë.

Ky vit shënon edhe një rritje të përgjithshme të studentëve debitorë.

Për vitin akademik 2023-2024, numri i studentëve debitorë për ciklin e parë është 91 me efekt financiar 2,275,000 lekë dhe për ciklin e dytë 207 debitorë me efekt financiar, 17,737,200 lekë.

#### *Efekti financiar i studentëve debitorë*

Nr.	Cikli i Studimit	Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2022-2023	
		Studentë debitorë	Efekti financiar	Studentë debitorë	Efekti financiar	Studentë debitorë	Efekti financiar
1	Cikli i parë (Bachelor)	96	2,362,500	157	4,000,500	254	6,720,000
2	Cikli i dytë (Master Shkencor)	177	17,682,000	234	28,854,500	235	23,079,000
3	Cikli i dytë (Master Profesional)	148	9,752,400	233	15,386,400	166	10,771,200
4	Cikli i Tretë (Doktoratura)	-	-	-	-	-	-

*Burimi: FEUT*

#### *Studentet debitore*

Nr.	Cikli i Studimit	Viti akademik 2023-2024	
		Studentë debitorë	Efekti Financiar (lekë)
1	Cikli i parë (Bachelor)	91	2,275,000
2	Cikli i dytë (Master Shkencor)	207	17,737,200
3	Cikli i dytë (Master Profesional)		
4	Cikli i Tretë (Doktoratura)	-	-

#### **Konkluzion.**

Sikurse vihet re, realizimi i të ardhurave për vitin 2021 dhe 2022 është në masën 87%, ndërsa në vitin 2023 kemi një realizim prej 135% për shkak të arkëtimit të tarifave të shkollimit të prapambetura në vite nga ana e FEUT.

Të ardhurat dytësore për vitin 2024 janë në nivelin 27.4% mbi planin ose në vlerë 37,819,000.0 lekë, duke treguar një performancë më të mirë në mbledhjen e tyre. Por megjithatë këtë rritje në mbledhjen e të ardhurave mbetet i rëndësishëm fakti që po ashtu kemi një rritje të konsiderueshme të numrit të studentëve, të cilët frekuentojnë aktivitetin mësimor por njëkohësisht janë debitorë, kryesisht në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Të ardhurat e munguara për shkak të debisë së krijuar bëhen pengesë për realizimi e të ardhurave e për rrjedhim për zbatimin e buxhetit. Pavarësisht se këta studentë nuk mund të diplomohen ose të marrin pjesë në provime, mangësia reflektohet në të ardhurat e munguara e për pasojë në parashikimin dhe realizimin e shpenzimeve.

#### **2.2 Auditim i zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave**

Në zbatim të pikës 2, të programit të auditimit nr.103/27, datë 27.12.2024, u shqyrtua

dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Vendimet e Bordit të Administrimit të UT mbi miratimin e strukturës organizative, për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2024;
- 2) Vendimi i BA-së nr.119 datë 17.07.2019 “Për miratimin e gjurmës së auditit për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Universitetin e Tiranës”.
- 3) Vendimet e Rektorit/Administratorit për emërimet, largimet dhe zbatimin strukturave organizative, për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2024;
- 4) Dokumentacioni i dosjeve individuale të punonjësve të institucionit;
- 5) Listëpagesat mujore për periudhën objekt auditimi;
- 6) Vendim i rektoratit nr.2 datë 24.01.2022 “Për miratimin e manualit mbi punësimin e personelit në Universitetin e Tiranës”.

Në Fakultetin Ekonomik marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit të Punës, Ligj Nr. 7961, datë 12.7.1995, i ndryshuar. Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 29 datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar, Ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 57 pika 1, ku përcaktohet se “Personeli i institucionit të arsimit të lartë përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës akademik dhe personeli administrativ”.

Nga auditimi për vitin 2021 Fakulteti Ekonomik ka funksionuar me strukturë të miratuar nga Bordi i Administrimit me vendimet nr. 8 datë 08.04.2021 me të cilin është miratuar struktura në total me 626 punonjës nga të cilët 250 staf me kohë të plotë dhe 376 punonjës me kohë të pjesshme, me kontratë dhe të ftuar. Me vendimin nr. 49 datë 26.11.2021 është bërë ndryshimi i strukturës organizative. U konstatua se gjatë vitit 2021 realizimi i strukturës organizative është në masën 83%.

Nga auditimi për vitin 2022 Fakulteti Ekonomik ka funksionuar me strukturë të miratuar nga Bordi i Administrimit me vendimet nr. 12 datë 07.04.2022 me të cilin është miratuar struktura në total me 626 punonjës nga të cilët 250 staf me kohë të plotë dhe 376 punonjës me kohë të pjesshme, me kontratë dhe të ftuar. U konstatua se gjatë vitit 2022 realizimi i strukturës organizative është në masën 78%.

Nga auditimi për vitin 2023 Fakulteti Ekonomik ka funksionuar me strukturë të miratuar nga Bordi i Administrimit me vendimin nr. 14 datë 11.04.2023 me të cilin është miratuar struktura në total me 626 punonjës nga të cilët 250 staf me kohë të plotë dhe 376 punonjës me kohë të pjesshme, me kontratë dhe të ftuar. U konstatua se gjatë vitit 2023 realizimi i strukturës organizative është në masën 75%.

Nga auditimi për vitin 2024 Fakulteti Ekonomik ka funksionuar me strukturë të miratuar nga Bordi i Administrimit me vendimin nr. 12 datë 18.03.2024 me të cilin është miratuar struktura në total me 521 punonjës nga të cilët 245 staf me kohë të plotë dhe 276 punonjës me kohë të pjesshme, me kontratë dhe të ftuar. U konstatua se gjatë vitit 2024 realizimi i strukturës organizative është në masën 96%. Struktura për periudhën objekt auditimi pasqyrohet në aneksin nr. 1 bashkëlidhur.

Nga auditimi i rekrutimeve për periudhën e auditimit u konstatua se gjatë vitit 2021 janë rekrutuar 39 persona, për vitin 2022 janë rekrutuar 18 persona, për vitin 2023 janë rekrutuar 14 persona dhe për vitin 2024 janë rekrutuar 8 persona. Nga dosjet e përzgjedhura të personelit akademik të rekrutuar për auditim, u konstatua se janë ndjekur procedurat bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit

të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statuti Universitetit të Tiranës, Vendim i rektoratit nr.2 datë 24.01.2022 “Për miratimin e manualit mbi punësimin e personelit në Universitetin e Tiranës” dhe dispozitat ligjore lidhur me rekrutimin e stafit akademik duke filluar që nga kriteret për vendet vakante, njoftimi për shpalljen e konkursit në Agjencinë e Prokurimeve Publike, vendimi për krijimin e komisionit AD-HOC për përzgjedhjen e kandidateve, procesverbali për përcaktimin e metodologjisë dhe vlerësimit për përzgjedhjen, procesverbali i vlerësimit nga komisioni AD-HOC, vendimi i komisionit, përcjellja e vendimit Dekanit të fakultetit dhe në fund përcjellja e vendimit për miratim Rektorit dhe vendimi i Rektorit.

Nga auditimi i largimeve nga puna u konstatua se gjatë vitit 2021 janë larguar 8 persona, gjatë vitit 2022 janë larguar 16 persona, gjatë vitit 2023 janë larguar 11 persona dhe gjatë vitit 2024 janë larguar 11 persona. Arsyet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës janë për mbushje të moshës së pensionit dhe me dorëheqje për arsye personale. Të gjitha procedurat për largimet nga puna janë kryer në respekt të dispozitave ligjore të Kodit të Punës që nga njoftimet nga ana e punonjësve deri në vendimet nga ana e Rektorit.

Nga auditimi i përlllogaritjeve të pagave në Fakultetin Ekonomik u konstatua se për vitin 2021 ato janë përlllogaritur në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.268, datë 29.03.2017 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar”. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.202, datë 15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar”.

Për vitin 2022 pagat janë përlllogaritur në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.647, datë 05.10.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar”, vendimit të bordit administrimit nr. 53, datë 31.10.2022 “Për miratimin e pagave të stafit akademik sipas vendimit nr. 647, datë 05.10.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 28.09.2022 për ndryshime në VKM-në nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 28.09.2022 për disa ndryshime në vendimin nr. 234, datë 20.4.2022, të këshillit të ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”.

Përlllogaritja e pagave për vitin 2023 është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.243, datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në

institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, vendimin e Bordit të Administrimit nr. 16, datë 12.05.2023 “Për miratimin e pagave të stafit akademik sipas vendimit nr. 243, datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, vendimi i Bordit të Administrimit nr.24, datë 10.07.2023 “Mbi miratimin e kategorive dhe nivelit të pagave për personelin ndihmës akademik, administrativ në Universitetin e Tiranës në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325 datë. 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave të nëpunësve civile/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 20.04.2023 “Për ndryshime në VKM-në nr. 234, datë 20.4.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të Specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës publike”.

Për vitin 2024 përlllogaritja ka vijuar në zbatim të dispozitave të mësipërme si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 421 datë 26.06.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 325 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave të nëpunësve civile/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar, vendimit nr. 422 datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr. 26 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe të punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar.

Në përlllogaritjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore është zbatuar Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësorë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Për përlllogaritjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore suplementare është zbatuar Ligji nr. 10139 datë 15.05.2009 “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, qendrës albanologjike, akademisë së shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë” i ndryshuar. Në përlllogaritjen tatimit mbi të ardhurat nga punësimi është zbatuar Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Përlllogaritjet për paga dhe sigurime shoqërore për periudhën objekt auditimi pasqyrohet si në tabelën nr. 2 në aneksin bashkëlidhur.

Nga sa më sipër shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore për personelin me kohë të plotë financohen nga të ardhurat nga buxheti kap 8 ndërsa shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore për personelin akademik me kohë të pjesshme financohen nga të ardhurat dytësore kap 6 të krijuara nga fakulteti.

Nga auditimi me përzgjedhje i formularëve të planifikimit, shpërndarjes së ngarkesave dhe mbingarkesave në Fakultetin e Ekonomik, në formularin e planifikimit në zbatim të udhëzimit nr.29 datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë” i ndryshuar, pasqyroheshin të dhënat nga “*veprimtaria mësimdhënëse*” e detajuar e personelit akademik, programet e studimit, lëndët mësimore sipas planeve të miratuara, orët e specifikuara. Ndërsa veprimtaria tjetër “*kërkimi shkencor*”, “*kontributi institucional*”, dhe “*kontributi profesional*” nuk raportohet e detajuar. Pasqyrohet realizimi i kohës vjetore të punës sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.29 datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë” i ndryshuar, kreu III, pika 1 ku citohet “*Çdo anëtar i personelit akademik i punësuar me kohë të plotë në IAL duhet të përmbushë detyrimet për kohën vjetore të punës prej 1536 orë*”.

Realizimi i ngarkesave dhe mbingarkesave mësimore konfirmohet nga pedagogu i lëndës,

përgjegjësi i departamentit dhe administratori i Universitetit. Sipas viteve akademike realizimi i orëve pasqyrohet si në tabelën nr. 3 në aneksin bashkëlidhur.

Nga auditimi u konstatua se ngarkesa me orë shtesë për të gjitha vitet objekt auditimi shumë më e madhe se norma mësimore. Fondet për pagesën e orëve shtesë financohen nga të ardhurat dytësore të fakultetit kap 6 dhe efekti i tyre financiar përlllogaritet në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 268 datë 29.03.2017 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 748 datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”. Në total për vitin 2024 shpenzimet për mbingarkesë kapin shifrën 67,479,566 lekë, për vitin 2023 pagesa për mbingarkesën ka qenë 44,615,781 lekë, për vitin 2022 janë paguar 57,172,201 lekë për mbingarkesën mësimore ndërsa për vitin 2021 janë paguar 51,515,918 lekë për mbingarkesë mësimore.

Nga auditimi me përzgjedhje i urdhër shpenzimeve lidhur me pagesat e personelit akademik me kohë të pjesshme, u konstatua se ato realizohet në fund të periudhës mësimore, në moszbatim të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 6 Mbrojtja e detyrueshme thekson “Sigurimet shoqërore, gjithashtu, i japin mbrojtje të detyrueshme të gjithë personave të punësuar, në rastin e pakësimit të të ardhurave, si pasojë e paaftësisë së përkohshme të shkakuar nga sëmundja, aksidenti në punë, sëmundja profesionale dhe papunësia.” Neni 8 Periudha e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore thekson “Periudha e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore nis ditën kur personi e ka filluar ligjërisht veprimtarinë ekonomike dhe mbaron ditën kur përfundon ligjërisht kjo veprimtari”. Neni 79 ku citohet: Punëdhënësi dhe i vetëpunësuarit janë të detyruar: a) të regjistrojnë në regjistrin vjetor të gjithë të punësuarit; b) të njoftojnë në organet tatimore për ndryshimet dhe lëvizjen e punonjësve, sipas procedurave të përcaktuara me ligj; c) të bëjnë sigurimin nga dita e parë, kur i punësuarit fillon punë; ç) të dorëzojnë në organet tatimore dokumentacionin, ku evidentohen paga dhe kontributi për çdo të punësuar, sipas formatit dhe afateve të përcaktuara me ligj si dhe realizohet deklarimi i punonjësve me kontratë pune të pjesshme të paktën 24 orë përpara fillimit të punës sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Subjekti duhet ti kishte regjistruar në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas planit mësimor bashkëlidhur kontratës pasi këta punonjës e kanë ofruar shërbimin e tyre sipas muajve respektiv dhe ti paguante po sipas këtyre muajve. Ky veprim i ka privuar nga e drejta për të qenë përfitues sipas ligjit të mësipërm për periudhën për të cilën ata kanë ofruar shërbimin.

Gjithashtu u konstatuan pagesa për “Grupin e punës për pjesëmarrjen në komisionin e përhershëm të dhënies së gradës "Doktor"”. Pagesat për pjesëmarrjen në komisionin e përhershëm janë përcaktuar me vendimin e Bordit të Administrimit nr. 118 datë 17.07.2019 “Për miratimin e punës të komisioneve të përhershme në UT” ka miratuar shpërblime për komisionet e përhershme në masën e shpërblimit për anëtarët e tyre në Universitet në vlerën prej 15,000 lekë, ndërsa për komisionet e përhershme në fakultete në vlerën prej 10,000 lekë mbështetur në Statutin e Universitetit të Tiranës, miratuar me urdhrin e ministrit të arsimit nr.816 datë 26.12.2018 , në nenin 29 pika 7, ku citohet se: “Anëtarët e Senatit, të Bordit dhe anëtarët e komisioneve të përhershme shpërblehen financiarisht në përputhje me kontributet e tyre. Shpërblimi miratohet nga Bordi i Administrimit, mbështetur në mundësitë financiare të Universitetit dhe në kuadrin ligjor në fuqi”.

Nga auditimi me përzgjedhje u konstatua se të gjitha pagesat, (të ardhurat) që përfitohen nga stafi i fakultetit i shtohen pagës bazë dhe i nënshtrohen ndalesa sipas dispozitave ligjore.

## 2.3 Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare

### a) Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes arkës

Nga auditimi me zgjedhje për vitet objekt auditimi mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër shpenzim, etj.) i kryer në Sektorin e Financës, për veprimet e arkës rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësisve që varen prej tyre”, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore”, i ndryshuar. Transaksionet janë kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe gjendja e llogarive bankare rakordon me ekstraktet e bankës në fund të çdo muaji. Të gjitha tërheqjet me çek nga banka, janë bërë hyrje në arkë dhe kontabilizimi i tyre në ditarin e bankës dhe të arkës. Nga auditimi i shpenzimeve për udhëtime dieta me jashtë dhe dokumentacionit justifikues të mandat pagesave tek të gjitha praktikant, u konstatua se këto veprime janë kryesisht në përputhje me *VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, dhe pikën 4 të Udhëzimit nr. 22, date 10.07.2013 të Ministrisë së Financave.*

### Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes bankës

Në pagesat e kryera me urdhër shpenzime nuk u konstatuan mangësi në hartimin dhe mbajtjen e dokumentacionit justifikues për lëvrimin e tyre. Është bërë regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e barabartë me ekstraktin e saj, kjo për sa i përket veprimeve të kryera gjatë vitit. Nga verifikimi i regjistrimit të veprimeve, shpenzimet janë regjistruar me numra rendor, në mënyrë kronologjike. Në përgjithësi urdhër shpenzimet kishin të bashkëlidhur dokumentin justifikues si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimit, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.

### Tejkalimi i afatit 30 ditor të likuidimit të faturave

Grupi i auditimit kreu me zgjedhje testime për të identifikuar pagesat e kryera për periudhën objekt auditimi me datën e urdhër shpenzimit mbi 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së furnitorit. *Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 52 dhe në Ligjin Nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7.*

### Fatura të likuiduara me vonesë

Numri dhe data e urdhër-shpenzimeve	Data e Faturës së dorëzuar nga subjekti	Vlera totale		
		(lekë)	Ditë vonese	
107	28.06.2022	28.04.2022	120,000	61
	28.06.2022	28.04.2022	98,750	61
	05.07.2022	28.04.2022	100,000	68
	26.08.2022	12.05.2022	118,260	106
	21.12.2023	09.11.2023	96,000	41
111	26.08.2022	12.05.2022		76

**Viti 2022:** -Procedura e Prokurimit me vlerë të vogël “Realizim Shërbime-Aktivitete të ndryshme në Dekanat” me fitues H. G. për vlerën 120,000 lekë. Urdhër-Shpenzimi nr. 107 datë

28.06.2022, Procesverbal i Marrjes në Dorëzim datë 28.04.2022, diferenca 61 ditë.

-Procedura e Prokurimit me vlerë të vogël “*Rollup me mekanizëm për konferenca shkencore*” me fitues L. C. për vlerën 98,750 lekë. Urdhër-Shpenzimi datë 28.06.2022, Procesverbal i Marrjes në Dorëzim datë 28.04.2022, diferenca 61 ditë.

-Procedura e Prokurimit me vlerë të vogël “*Realizim shërbime dhe artikuj në aktivitet për Ceremoni Diplomimi*” me fitues S. A. ShPK për vlerën 100000 lekë. Urdhër-Shpenzimi datë 05.07.2022, Procesverbal i Marrjes në Dorëzim datë 28.04.2022, diferenca 68 ditë.

-Procedura e Prokurimit me vlerë të vogël “*Shërbim në Dekanat coffe break në aktivitete me partner sponsorizues*” me fitues L. C. për vlerën 118,260 lekë. Urdhër Shpenzimi nr. 111 datë 26.08.2022, Procesverbal i Marrjes në Dorëzim 12.05.2022, diferenca 106 ditë.

**Viti 2023:** -Procedura e Prokurimit me vlerë të vogël “*Veshje sportive për student në aktivitete të ndryshme, kampionate dhe organizime studentore*” me fitues OE S. M. për vlerën 96,000 lekë. Urdhër-Shpenzimi datë 21.12.2023, Procesverbal i Marrjes në Dorëzim datë 09.11.2023, diferenca 41 ditë.

### **Konkluzion**

Nga kryerja e testeve mbi urdhër shpenzimet, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkualuar afatin ligjor. Konkretisht, janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton Ligji për “*Menaxhimin e Sistemit Buxhetor*” si dhe Ligjin nr.48/2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” neni 7, si më poshtë:

Për vitin 2022: Urdhër-Shpenzimi nr. 107 datë 28.06.2022, Procesverbal i Marrjes në Dorëzim datë 28.04.2022 dhe fatura në të njëjtën datë kanë një diferencë prej *31 ditësh* mbi afatin e lejuar.

-Urdhër-Shpenzimi datë 28.06.2022, Procesverbal i Marrjes në Dorëzim datë 28.04.2022 dhe fatura e të njëjtës datë, afati i tejkualuar *me 31 ditë*. Urdhër-Shpenzimi datë 05.07.2022, Procesverbal i Marrjes në Dorëzim datë 28.04.2022 dhe fatura në të njëjtën datë, afati i tejkualuar *me 38 ditë*. Urdhër Shpenzimi nr. 111 datë 26.08.2022, Procesverbal i Marrjes në Dorëzim 12.05.2022 dhe fatura e të njëjtës datë, afati i tejkualuar me 76 ditë.

-Për vitin 2023: Urdhër-Shpenzimi datë 21.12.2023, Procesverbal i Marrjes në Dorëzim datë 09.11.2023 dhe fatura e të njëjtës datë, afati i tejkualuar *me 11 ditë*. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” neni 7 dhe Udhëzimin Nr. 30 datë 27.12.2011 i ndryshuar, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” pika 61.

Për sa është trajtuar në lidhje me pikën e mësipërme në Projekt Raportin e Auditimit, është paraqitur observacioni me nr. 620/7 prot., datë 31.07.2025, protokolluar në KLSH me nr. 103/34 datë 01.08.2025, nga z. E. H. me pozicion Administrator i Fakultetit të Ekonomisë, për të cilin japim sqarimet si më poshtë.

### **Pretendimi i subjektit:**

Fakulteti i Ekonomisë ka patur 9 raste për vitin 2022 dhe 2 raste nga viti 2023 në total 11 raste nga 140 të testuara nga Auditimi, të cilat kanë ardhur për arsye tërësisht objektive duke e bërë të pamundur pagesën brenda afatit 30 ditor. Të 11 rastet e gjetura janë fatura të cilat janë prerë në fund të vitit buxhetor (respektivisht 9 rastet në fund të vitit 2021 dhe 2 rastet në fund të vitit 2022) pasi Dega e thesarit nuk ka mundur ti likujdojë në kohë brenda vitit për shkak të ngarkesës dhe pamundësisë së kësaj të fundit. Këto 11/140 raste, janë reklamuar dhe janë trajtuar si detyrime të prapambetura për t’u likujduar në buxhetin e vitit të ardhshëm. Theksojmë se tejkalimi i afatit 30 ditor është kryer për shkakun e vetëm se veprimet me Degën e Thesarit

Tiranë, nuk mund të realizohen pa u miratuar Buxheti i Konsoliduar i Universitetit të Tiranës dhe që ky i fundit është miratuar për një periudhë më të gjatë sesa afati 30 ditor nga data e faturës origjinale të OE.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit dhe sqarimit të observacionit të paraqitur nga ana juaj sqarojmë se, sipas tabelës më lart trajtuar në material vetëm fatura me datë 09.11.2023 i përket fundit të vitit, ndërsa faturat e tjera të gjitha janë në periudha të mëhershme, pra Dega e thesarit mund ti likujdonte në kohë brenda vitit në rast se urdhër shpenzimet do dërgoheshin në kohë.

Për sa më lart observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

## **Transfertat për UT**

### **Viti 2021:**

Transferata të tjera në vitin 2021: Sistemim Trotuari dhe punime fasade në godinën e FE-UT, kontrata nr. 2305/12, datë 16.11.2020: Urdhër Shpenzimi nr. 292, datë 21.12.2021, vlera 15,000,000 lekë.

### **Viti 2022:** Projektet e investimeve me financim të brendshëm (të ardhura) për vitin 2022.

#### Projektet e investimeve me financim të brendshëm për vitin 2022

Nr.	Emërtimi i Projektit	Financim Viti 2022	Realizimi	Urdhër-Shpenzim	Vlera e Transfertës
1	Pajisje kompjuterike stafin FE	20,000	Realizuar		
2	Sistem Aspirim Kondicionimi Godina A	4,000	Pa realizuar		
3	Blerje pajisje elektronike fotokopje kombinat	2,500	Realizuar		
4	Blerje librash	5,000	Realizuar		
5	Dritare plastike dhe grila godina A	15,000	Pa realizuar		
6	Mobilim Godina A dhe Biblioteka-Rinovim Hapësire Fondi i Librave	5,000	Pa realizuar		
7	Kontratë Nr. 2512/19, datë 24.01.2022 "Blerje pajisje mobilimi dhe grila UT"	13,872	Realizuar	-07.04.2022 USH nr.52 -14.10.2022 USH nr.194	-E papërcaktuar -E papërcaktuar
8	Kontratë Nr. 2515/11, datë 01.12.2021 "FV pajisje teknike operacionale kondicioner chiller sis. Aspirimi etj."	1,433	Realizuar	-07.04.2022 USH nr.52 -14.10.2022 USH nr.194	-E papërcaktuar -E papërcaktuar
9	Kontratë nr. 2513/15, datë 02.02.2022 Loti 1 Blerje pajisje elektronike	6,320	Realizuar	-07.04.2022 USH nr.52 -14.10.2022 USH nr.194	-E papërcaktuar -E papërcaktuar
10	Kontratë nr. 2513/15, datë 02.02.2022 Loti 2 Blerje pajisje audio vizuale	3,591	Realizuar	20.12.2022 USH nr.254 -14.10.2022 USH nr.194	-E papërcaktuar -E papërcaktuar
11	Kontratë nr. 4217/8, datë 14.02.2022 "Blerje fond libri"	6,632	Realizuar	-20.12.2022 USH nr.254. -14.10.2022 USH nr.194	-E papërcaktuar -E papërcaktuar
12	Kontratë 6248 datë 28.09.2021 "Upgrade i aplikimit softëare e Student për UT"	8,300	Realizuar	-20.12.2022 USH nr.254 -14.10.2022 USH nr.194	-E papërcaktuar -E papërcaktuar

### **-Transfertat për UT në vitin 2022**

-Urdhër Shpenzimi nr. 52, datë 07.04.2022 me vlerë 20,000,000 lekë (bazuar në Urdhër nr.457 prot., datë 05.04.2022 Transferim Fondi. Urdhër Shpenzimi nr. 194, datë 14.10.2022 me vlerë 20,000,000 lekë (bazuar në Urdhër nr.1267 prot., datë 06.10.2022. Transferim Fondi nga Administratori. Shuma e këtyre dy Urdhër Shpenzimeve është **40,000,000 lekë** ndërkohë që vlera e kërkuar nga Rektorati është **41,547,674 lekë**, pra kanë një **diferencë prej 1,547,674 lekë**. Nga sa më sipër nuk është e qartë vlera që është përdorur nga transferata e FEUT për secilën kontratë, përkatësisht: Kontrata nr.2601/12 datë 16.12.2020 "Blerje pajisje mobilimi dhe

Kontrata nr. 2513/15, datë 02.02.2022 Loti 2: “Blerje pajisje audio-vizive”.

Urdhër Shpenzim nr.254, datë 20.12.2022 me vlerë 13,377,020 (bazuar në Urdhër nr.1683 prot., të FEUT për Transferim Fondi). Në Urdhër shpenzim nuk është e përcaktuar si është ndarë kjo vlerë për të dy kontratat. Gjithashtu kontrata “Blerje pajisje mobilimi” nuk ka qenë e përfshirë në listën e investimeve që do të paguhen nga FEUT për vitin 2022.

### **Viti 2023.**

Projektet e investimeve me financim të brendshëm (të ardhura) për vitin 2023, janë pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

#### Projektet e investimeve me financim të brendshëm (viti 2023)

Nr.	Emërtimi i Projektit	Financim Viti 2023	Realizimi	Urdhër-Shpenzimi	Vlera e Transfertës
1	Pajisje elektronike	4,000	Realizuar		
2	Libra, të drejta për portale; akademike	9,409	Pa realizuar		
3	Zëvendësim dritare, grila, godina A	3,722	Realizuar		
4	Realizim Lab. Qendre departamenti i Financës	3,500	Pa realizuar		
5	Loti 1: Blerje pajisje elektronike	16,776	Realizuar	04.09.2023 USH nr.177	E papërcaktuar
6	Furnizim vendosje pajisje “Mobilimi për UT”	5,340	Realizuar	04.09.2023 USH nr.177	E papërcaktuar
7	Objekti i Kontratës: Rikonstrukcion Biblioteke UT (Godinë Shërbimi 4 kate mbi tokë për UT)”	15,841	Realizuar	04.09.2023 USH nr.177	E papërcaktuar
8	Mbikëqyrje + Kolaudim “Mirëmbajtje ndërtesë”	74	Realizuar	04.09.2023 USH nr.177	E papërcaktuar

#### **- Transfertat për UT në vitin 2023:**

Më 20.07.2023 nr.2145 Prot., Universiteti i Tiranës i përcjell FEUT shkresën mbi transferim fondi. Për të përmbushur këtë kërkesë u realizua Urdhër Shpenzim nr.177, datë 04.09.2023 me vlerë 20,000,000 lekë (bazuar në Urdhër nr.1315 Prot, datë 04.09.2022 Transferim Fondi). ndërkohë që vlera e kërkuar nga Rektorati është 21,130,000 lekë , pra kanë një **diferencë prej 1,130,000 lekë.**

Nga auditimi rezultoi se ndërmjet Urdhër Shpenzimit nr.177, datë 04.09.2023 dhe vlerës së transferuar ,së kërkuar nga UT ka një diferencë prej 1,130,000 lekë, për të cilën nuk është e qartë si është përdorur vlera nga transferata e FEUT për secilën kontratë.

#### **Konkluzion:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar dhe urdhër-shpenzimeve të lidhura me transferimet e fondeve nga FEUT drejt Rektoratit të Universitetit të Tiranës, u konstatua mungesë transparence dhe qartësie në lidhje me përdorimin dhe ndarjen e vlerave përkatëse për secilën kontratë. Konkretisht, ekziston një mospërputhje ndërmjet shumave të kërkuara nga Rektorati dhe atyre të ekzekutuara me urdhër-shpenzim, me diferenca përkatësisht prej **1,547,674 lekë** për vitin 2022 dhe **1,130,000 lekë** për vitin 2023.

Gjithashtu, në dokumentacionin mbështetës mungon përcaktimi i qartë i ndarjes së fondeve për kontratat “Blerje pajisje mobilimi” dhe “Blerje pajisje audio-vizive”, ndërkohë që njëra prej këtyre kontratave nuk rezulton e përfshirë në listën e investimeve të miratuara për financim nga FEUT për vitin përkatës. Këto mangësi cenojnë transparencën, gjurmueshmërinë e përdorimit të fondeve dhe rrisin rrezikun për përdorim joefikas ose të paautorizuar të burimeve financiare.

## **2.4 Auditim i llogarive vjetore**

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar për vitet 2021 - 2024;
- 2- Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet 2021 - 2024;

- 3- Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare për vitet 2021 - 2024;
- 4- Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto për vitet 2021 - 2024;
- 5- Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për vitet 2021 - 2024;
- 6- Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre për vitet 2021 - 2024;
- 7- Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto për vitet 2021 - 2024;
- 8- Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave për vitet 2021 - 2024.

**a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.**

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018.”

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin e MF me nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

U konstatua se, veprimet kontabël janë azhornuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarë të mbajtur në programin excel, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Fakulteti i Ekonomisë, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MF), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore.

Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat Financiare vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

Për vitin 2021 dhe 2022 janë dorëzuar Pasqyrat Financiare të Fakultetit të Ekonomisë pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresat respektive nr. 440 Prot., datë 31.03.2022 “Dërgohen pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2021”, dhe nr. 526 prot datë 31.03.2023 “Dërgohen pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2022”. Shkresat e mësipërme janë protokolluar nga Dega e

Thesarit Tiranë respektivisht me nr. 2384 prot datë 31.03.2022 dhe 787/298 prot datë 31.03.2023 Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023 u **konstatua** se ato janë dorëzuar në degën e thesarit me shkresën përcjellëse nr. 614 prot datë 25.04.2024 protokolluar në Degën e Thesarit me nr 1300/338 datë 25.04.2024 në tejkalim të afatit të përcaktuar në Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 117 e cila sanksionon se: “Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit.”

Për vitin 2024 janë dorëzuar Pasqyrat Financiare të Fakultetit të Ekonomisë pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresat respektive nr. 543 Prot., datë 01.04.2025 “Dërgohen pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2025” protokolluar në degën e thesarit me nr. 2412 prot. datë 01.04.2025.

Gjithashtu, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

***b. Vlerësimi nëse drejtat dhe detyrimet janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.***

Në kuadër të standardeve të raportimit financiar (SNK 1) objektivi i pasqyrave për qëllime të përgjithshme është të sigurojnë informacion lidhur me pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike që është i dobishëm për një grup të gjerë përdoruesish në marrjen e vendimeve ekonomike. Pasqyrat financiare tregojnë gjithashtu dhe rezultatet e drejtimit lidhur me administrimin e burimeve që u janë besuar. Pasqyrat financiare do të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin konceptual për raportimin financiar (Kuadri konceptual).

**Pasqyra financiare**

Në zbatim të udhëzimit nr. 8, datë 03.09.2018, Kapitulli V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore”, i ndryshuar. Pasqyrat Financiare kanë për qëllim që të japin një pamje të strukturuar të pozicionit financiar dhe transaksioneve për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme, të sigurojnë informacion për pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare.

Qëllimi i përgjithshëm është që me informacionin që disponojnë, pasqyrat financiare, në radhë të parë të japin informacion të besueshëm për vendimmarrje për vetë njësinë apo institucionin raportues, nëpërmjet sigurimit të informacionit rreth burimeve financiare dhe alokimin e tyre, informacionit për mënyrën e financimit të aktiviteteve të njësisë dhe realizimit të kërkesave monetare, lidhur me aftësinë e njësisë për të financuar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet, informacionit për vlerësimin e performancës së njësisë.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2024 dhe ato të vitit 2023 u **konstatua** se tepricat e pasqyruara në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 në pasqyrat e vitit 2023 nuk përputhen me tepricat në çelje të vitit ushtrimor 2024 në pasqyrat e vitit 2024. Ky mosrakordim cenon parimin e

krahasueshmërisë SKK 1 Kuadri i Përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare, Informacioni krahasues minimal “për të gjitha shumatat e raportuara në pasqyrat financiare duhet të paraqitet informacion krahasues në lidhje me periudhën e shkuar për të gjitha shumatat e raportuara në pasqyrat financiare të periudhës aktuale.” Sektori i financës të rishikoja mbartja e tepricave të llogarive kontabël në fillim të periudhës raportuese dhe të bëhet sipas mbylljeve të llogarive kontabël të periudhës së mëparshme. Ndryshimet e tepricave të llogarive kontabël të bëhen brenda periudhës kontabël raportuese.

## **Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale të Fakulteti Ekonomisë u konstatua se:**

### **1. Pasqyra e pozicionit financiar**

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar tre pjesët përbërëse të saj paraqiten si më poshtë:  
Për vitin 2021

a- Të drejtat (Aktivet)	880,382 mijë lekë
b- <u>Detyrimet (Pasivet)</u>	<u>24,053 mijë lekë</u>
c- Fondet Neto (Aktivet neto)	856,329 mijë lekë

**Aktivet neto plotësojnë rregullin Aktive – Pasive = Aktivet Neto (856,329 mijë lekë).**

Për vitin 2022

a- Të drejtat (Aktivet)	862,100 mijë lekë
b- <u>Detyrimet (Pasivet)</u>	<u>27,783 mijë lekë</u>
c- Fondet Neto (Aktivet neto)	834,316 mijë lekë

Aktivet neto plotësojnë rregullin Aktive – Pasive = Aktivet Neto (834,316 mijë lekë).

Për vitin 2023

a- Të drejtat (Aktivet)	736,691 mijë lekë
b- <u>Detyrimet (Pasivet)</u>	<u>43,351 mijë lekë</u>
c- Fondet Neto (Aktivet neto)	693,339 mijë lekë

Aktivet neto plotësojnë rregullin Aktive – Pasive = Aktivet Neto (693,339 mijë lekë).

Për vitin 2024

a- Të drejtat (Aktivet)	744,389 mijë lekë
b- <u>Detyrimet (Pasivet)</u>	<u>43,330 mijë lekë</u>
c- Fondet Neto (Aktivet neto)	701,058 mijë lekë

Aktivet neto plotësojnë rregullin Aktive – Pasive = Aktivet Neto 701,058 mijë lekë).

### **1.1. Të Drejtat (Aktivet)**

Aktivet më datë 31 dhjetor të periudhave të auditimit pasqyrohen dhe përbëhen nga tabela 4 në aneks.

Nga auditimi u konstatua se në vitin 2021 Aktivet e afatshkurtra kanë zënë 15% të totalit të Të Drejtave në vlerë 129,119 mijë lekë ndërsa Aktivet afatgjata kanë zënë 85% të totalit, në vlerë 751,262 mijë lekë.

Gjatë vitit 2022 ky raport pothuajse nuk ka ndryshuar, më konkretisht aktivet e afatshkurtra kanë zënë 13% të totalit të të Drejtave në vlerë 112,030 (mijë lekë) ndërsa aktivet afatgjata kanë zënë 87% të totalit, në vlerë 750,070 (mijë lekë).

Gjatë vitit 2023 raporti ka ndryshuar, më konkretisht aktivet e afatshkurtra kanë zënë 18% të totalit të të drejtave në vlerë 132,732 (mijë lekë), ndërsa aktivet afatgjata kanë zënë 82% të

totalit, në vlerë 603,958 (mijë lekë). Për vitin 2024 raporti i strukturës së të Drejtave ka ndryshuar me rënie në 12% të aktiveve afatshkurtra pasqyruar në vlerë 87,553 (mijë lekë), ndërsa aktivet afatgjata pasqyrohen në shumën 656,836 (mijë lekë) me 88% të totalit të të drejtave. Ndryshimi në Aktivet afatshkurtra gjatë vitit 2022 në vlerë është në rënie me 17,089 (mijë lekë), në raport me peshën specifike të totalit të aktiveve është gjithashtu në rënie me 2%. Ky ndryshim është efekt i rënies së llogarive të arkëtueshme dhe konkretisht i rënies së mjeteve monetare dhe shtimit të inventarit qarkullues. Ndërsa ndryshimi në vlerë gjatë vitit 2023 është në rritje me 20,702 (mijë lekë) duke u rritur dhe në peshë specifike me 5% në raport me totalin e aktiveve, ky ndryshim është efekt i shtimit të mjeteve monetare dhe pakësimit të inventarit qarkullues. Ndryshimi gjatë vitit 2024, në shumën – 45,179 (mijë lekë) i aktiveve afatshkurtra është kryesisht efekt i rënies së mjeteve monetare dhe llogarive të arkëtueshme.

#### I.a Aktivet afatshkurtra (qarkulluese) AASH

Aktivët Afatshkurtra pasqyrohen në shumën 87,553,632 lekë për vitin 2024, në vlerën 132,732,829 lekë për vitin 2023, për vitin 2022 në shumën 112,030,531 lekë dhe për vitin 2021 në shumën 129,119,982 lekë dhe përbëhen nga shumat e rubrikave që përfaqësojnë:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 28,723,026 lekë për vitin 2024, në shumën 64,658,953 lekë për vitin 2023, për vitin 2022 në shumën 29,762,926 dhe për vitin 2021 në shumën 88,439,108 lekë
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 21,329,162 lekë për vitin 2024, në shumën 24,721,900 lekë për vitin 2023, për vitin 2022 në shumën 54,483,906 dhe për vitin 2021 në shumën 16,627,726 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 42,333,537 lekë për vitin 2024, në shumën 43,351,976 lekë për vitin 2023, për vitin 2022 në shumën 27,783,699 dhe për vitin 2021 në shumën 24,053,148 lekë.

#### **Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, përbëhet nga:**

Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës objekt auditimi në mbyllje të periudhave ushtrimore paraqiten respektivisht si vijon. Për vitin 2024 mjetet monetare në fund të periudhës mbyllen me tepricën në shumën 28,723,026 lekë, për vitin 2023 me tepricën në shumën 64,658,953 lekë, për vitin 2022 me tepricën në shumën 29,762,926 lekë dhe për vitin 2021 me tepricën në shumën 88,439,108 lekë. Tepricat në mbyllje për secilin vit ushtrimor rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të pasqyrave të flukseve monetare respektive.

Nga rakordimi me degën e thesarit lidhur me llogarinë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, llogarinë nr.466 “Mjete në ruajtje” dhe llogaritë e të ardhurave, u **konstatua** se nuk është mbajtur akt rakordim i të ardhurave dytësore të vitit 2021 që trashëgohen për vitin 2022.

Llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare objekt auditimi paraqitet në mënyrë analitike sipas tabelës 5 në aneks:

**Llogaritë e Klasës 3**, sipas Pasqyrave të Pozicionit Financiar të Fakulteti i Ekonomisë në 31.12.2024 teprica e kësaj klase është 21,329,162 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në shumën 17,415,683 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” në shumën 3,913,479 lekë.

Në 31.12.2023 pasqyrohet në shumën 24,721,900 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 21,364,991 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” në vlerën 3,356,909

lekë. Në mbyllje të periudhës 2022 kjo klasë pasqyrohet në shumën 54,483,906 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 50,508,678 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” në vlerën 3,975,228 lekë. Për periudhën e mbyllur në datën 31.12.2021 llogaria 31 “Materiale” ka tepricën 14,748,866 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” në vlerën 1,878,860 lekë sipas tabela 6 në aneks.

Diferencat me vitet e mëparshme përfaqësojnë lëvizjet e inventarit, konkretisht për vitin 2024-2023 ndryshimi është në shumën (3,392,738) lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 3,392,738 lekë, për vitin 2023-2022 ndryshimi është në shumën (29,762,006) lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 29,762,006 lekë. Për vitin 2022-2021 ndryshimi është në shumën 37,856,180 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën - 37,856,180 lekë.

Nga auditimi i librave të magazinës të vitit 2024 u konstatua se gjendja e llogarive kontabël është e kuadruar me gjendjen e inventarëve sipas tabelës 7 në aneks:

Gjendja e magazinës, sipas komisionit të inventarizimit, është gjendja sipas librave të magazinës e cila rakordon me gjendjen e llogarive kontabël të klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”. U konstatua se në kartelën analitike mallrat e klasës 3 nuk janë klasifikuar sipas llogarive kontabël Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

#### ▪ **Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme përbëhet nga:**

- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” sipas viteve respektive mbyllet me tepricat e pasqyruara në pasqyrat financiare në shumat 37,501,444 lekë për vitin 2024, për vitin 2023 43,351,976 lekë, për vitin 2022 në shumën 27,783,699 lekë dhe 24,053,148 lekë për vitin 2021. Këto teprica përfaqësojnë detyrimet për pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, detyrimet e TAP si dhe detyrime të tjera. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e detyrimeve 401,421, 431, 435, 436, 437 dhe 467. Llogaritë kundërparti të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në mënyre analitike dhe sintetike paraqitet sipas tabelës 8 në aneks:

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” përfaqëson detyrimet që kane të tretët ndaj fakultetit e cila për periudhën e auditimit është mbyllur me tepricë zero. Nga të dhënat e marra nga dega e shërbimeve të fakultetit të administruara nga grupi i auditimit në format shkresor u **konstatua** se për periudhën 2021 – 2024 janë 1,227 studentë debitorë të regjistruar në fakultetin Ekonomik me vlerë totale 85,834,100 lekë sipas tabelës 9 në aneks.

Studentë debitorë nga ana e fakultetit konsiderohen ata studentë, të cilët e kanë mbaruar procesin mësimor sipas cikleve, të cilët janë të diplomuar por që nuk iu është dhënë diploma si dhe studentët të cilët nuk janë diplomuar akoma. Nga këta studentë të cilët janë debitor, 242 studentë janë me status “Diplomuar” dhe 985 studentë janë me status “Padiplomuar” .

Në librat e kontabilitetit të fakultetit këto të dhëna nuk janë konstatuar apo kontabilizuar në zbatim të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

#### 1.1.b Aktivet Afatgjata

AAGJ përbëhen nga aktivet afatgjata materiale, të cilat mbyllen me tepricat në vlerat 603,958,442 lekë për vitin 2023, për vitin 2022 në vlerën 750,070,142 lekë dhe për vitin 2021 në

shumën 751,262,822 lekë. Këto teprica përbëhen nga shumat e rubrikave që përfaqësojnë llogaritë e grupit 212, 214, dhe 218 sipas pasqyrës 10 aneksi:

Aktivët afatgjatë materiale përbëhen nga:

- a- Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” mbyllet me tepricë në shumën 533,417,006 lekë për vitin 2024, për vitin 2023 me tepricë 561,491,585 lekë, për vitin 2022 me tepricë 09,636,713 dhe për vitin 2021 me tepricë 622,151,341 lekë;
- b- Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” mbyllet me tepricë në shumën 3,508,586 lekë për vitin 2024, për vitin 2023 me tepricë 40,971,860 lekë, për vitin 2022 me tepricë 8,005,327 dhe për vitin 2021 me tepricë 43,187,872 lekë;
- c- Llogaria 218 “Inventar ekonomik” mbyllet me tepricë në shumën 69,910,630 lekë për vitin 2024, për vitin 2023 me tepricë 1,494,997 lekë, për vitin 2022 me tepricë 102,428,102 dhe për vitin 2021 me tepricë 85,923,609 lekë.

*Llogaritë përbërëse të AAM analizohen si më poshtë:*

-Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 533,417,006 lekë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 561,491,585 lekë në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën prej 609,636,713 lekë ndërsa në fund të vitit 2021 mbyllet me tepricë 622,151,341 lekë.

Nga auditimi i pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (vlera neto)” të vitit 2021 llogaria 212 është shtuar me një vlerë prej 454,747,933 lekë. Kjo vlerë korrespondon me transferim kapitali nga Rektorati i Tiranës për Fakulteti Ekonomik konkretisht transferim kapitali i vlerës së ndërtesës nga asetet e Rektoratit të Tiranës në asetet për administrim nga Fakulteti Ekonomik. Transferimi i kapitalit është bërë me shkresën nr. 2777 prot datë 20.10.2021 në vlerën 440,225,508 lekë si dhe shkresën nr. 65 prot datë 11.01.2022 në vlerën 14,522,425 lekë.

Nga auditimi **u konstatua** se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 2%, të përdorur për të llogaritur amortizimin vjetor. Amortizimi në vlerë konstatohet në shumën 13,444,658 lekë ose 2% mbi vlerën kontabël neto në çelje të vitit ushtrimor shtuar me shtesat e transferimit të kapitalit sipas vlerave përkatëse. Sipas veprimeve të mësipërme nuk ka gjetur zbatim pika 36 e Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar i cili sanksionon se: “Për aktivët afatgjatë materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit, dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;”. Ky mbivlerësim na jep një pasqyrim jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar në datën 31.12.2021. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5 “Kontabiliteti në sektorin publik mbështetet në këto parime bazë: Pasqyrat financiare sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe paraqesin me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje. Ato përgatiten bazuar në një kontabilitet ushtrimor dhe në vijueshmërinë e veprimtarisë së njësisë së qeverisjes së përgjithshme, për një të ardhme të parashikueshme.”

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 3,508,586 lekë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 40,971,860 lekë, në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet me tepricë 38,005,327 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021

mbyllet me tepricë 43,187,872 lekë.

Nga auditimi i pasqyrave “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” për periudhën objekt auditimi rezultoi se: Për vitin 2021 llogaria 214 është shtuar me një vlerë prej 12,498,325 lekë dhe pakësuar me amortizimin prej 5,889,255 lekë. Për vitin 2022 vetëm është pakësuar me amortizimin në vlerë 5,182,545, ndërsa për vitin 2023 rezultojnë shtesa në shumën 29,881,174 lekë si dhe pakësime nga amortizimi vjetor në shumën 21,619,860 lekë dhe dalje jashtë përdorimi në shumën 23,887,720 lekë. Për vitin 2024 kemi shtesa në shumën 6,485,201 lekë dhe pakësime si rezultat i amortizimit në shumën 17,836,195 lekë.

Nga auditimi u konstatua se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 12% për vitet 2021 dhe 2022, të përdorur për të llogaritur amortizimin vjetor, ndërsa për vitin 2023 dhe 2024 është përdorur norma 25%. Për daljet jashtë përdorimi (pakësimet gjatë vitit 2023) nga pasqyra u konstatua se nuk është rimarrë amortizimi i akumuluar. Sipas veprimeve të mësipërme nuk ka gjetur zbatim pika 36 si dhe kapitulli “*Aktivet Afatgjata*” (Përbërja dhe trajtimi kontabël) të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar i cili sanksionon se: “*Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon: ... Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi.....*”. Efekti në pasqyrat e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosaplikimit të normës së saktë të amortizimit jap një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicioneve financiare. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar pika 5 “*Kontabiliteti në sektorin publik mbështetet në këto parime bazë: Pasqyrat financiare sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe paraqesin me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje. Ato përgatiten bazuar në një kontabilitet ushtrimor dhe në vijueshmërinë e veprimtarisë së njësisë së qeverisjes së përgjithshme, për një të ardhme të parashikueshme.*”

Gjithashtu mosaplikimi i rimarrjeve të amortizimit të akumuluar ndikon në vlerën neto të aseteve dhe mospasqyrimin e saktë të pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare.

-Llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 69,910,630 lekë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 1,494,997 lekë, në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet me tepricë 102,428,102 lekë ndërsa në fund të vitit 2021 mbyllet me tepricë 85,923,609 lekë.

Nga auditimi i pasqyrave “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” për periudhën objekt auditimi rezulton se: Për vitin 2021 llogaria 218 është shtuar me një vlerë prej 51,944,688 lekë dhe është pakësuar me amortizimin për 7,355,388 lekë dhe dalje jashtë përdorimi 107,657,515 lekë. Për vitin 2022 është shtuar 21,895,446 lekë dhe pakësuar me amortizimin për 5,390,953 lekë, ndërsa për vitin 2023 rezultojnë shtesa në shumën 5,339,820 lekë si dhe pakësime nga amortizimi vjetor në shumën 21,553,584 lekë dhe dalje jashtë përdorimi në shumën 84,719,341 lekë. Për vitin 2024 rezultojnë shtesa në shumën 1,173,950 lekë si dhe pakësime si efekt i amortizimit vjetor në shumën 17,477,658 lekë. Nga auditimi i pasqyrës së ndryshimeve të aktiveve afatgjata (vlera neto) u konstatua se amortizimi i akumuluar dhe

teprica neto në mbyllje në pasqyrat e vitit 2023 nuk rakordojnë me amortizimin e akumuluar dhe tepricën neto në çelje të vitit 2024 në pasqyrat e vitit 2024.

Nga auditimi u konstatua se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe norma e aplikuar e amortizimi 5% për vitet 2021 dhe 2022, ndërsa për vitin 2023 dhe 2024 është përdorur norma 20%. Për daljet jashtë përdorimi (pakësimet gjatë vitit 2023) nga pasqyra u konstatua se nuk është rimarrë amortizimi i akumuluar. Sipas veprimeve të mësipërme nuk ka gjetur zbatim pika 36 si dhe kapitulli “Aktivet Afatgjata” (Përbërja dhe trajtimi kontabël) të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar i cili sanksionon se: “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon: ... Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi.....”.

Efekti në pasqyrat e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosaplikimit të normës së saktë të amortizimit japin një pasqyrim jo të drejtë dhe të saktë të pozicioneve financiare të viteve ushtrimore, duke ndikuar në mos pasqyrimin e saktë të gjendjes neto të aktiveve. Gjithashtu mosaplikimi i rimarrjeve të amortizimit të akumuluar ndikon në vlerën neto të aseteve dhe mospasqyrimin e saktë të pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare.

Në regjistrin e aseteve, asetet nuk janë të evidentuara me llogaritë përkatëse kontabël.

## 1.2. Detyrimet (Pasivet)

Detyrimet në datat e mbylljes së periudhave ushtrimore përbehen vetëm nga detyrimet afatshkurtra, pasqyruar në Aneksin 11 bashkëlidhur Projekt Raportit.

Llogaritë e klasës 4, në pjesën e detyrimeve të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme. Ato paraqesin detyrimet e Fakultetit të Ekonomisë në datën 31 dhjetor të secilës periudhë kundrejt, punonjësve për paga, organeve tatimore për tatimin mbi pagat, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të analizuar si më poshtë:

- Llogaria 401-408, “Furnitorë e llogari të lidhura me to” përfaqëson shumën e detyrimeve që institucioni ka ndaj ofruesve të shërbimeve ose mallrave kryesisht të muajit dhjetor në shumën 997,427 lekë.

- Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit” e cila përfaqëson shumën e pagave neto të personelit të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, nga ku u konstatua se, për periudhat e auditimit këto teprica rakordojnë me vlerat sipas listëpagesave E-sig025.

- Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” përfaqëson tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për pagat e muajit dhjetor për secilën periudhë raportimi. Përkatësisht për vitin 2024 është në shumën 8,249,686 lekë, për vitin 2023 është në shumën 8,369,219 lekë, për vitin 2022 është në shumën 2,217,456 lekë si dhe për vitin 2021 është në shumën 1,750,883 lekë. Këto teprica në mbyllje të viteve ushtrimore rakordojnë me listëpagesat e deklaruar në organet tatimore.

- Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” përfaqëson vlerën kontributeve për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor për secilën periudhë raportimi. Përkatësisht për vitin 2024 janë në shumën 8,968,567 lekë dhe 1,913,642 lekë, për vitin 2023 janë në shumën 9,008,780 lekë dhe 1,935,410 lekë, për vitin 2022 janë në shumën 6,470,265 lekë dhe 877,134 lekë si dhe për vitin 2021 janë në shumën 5,369,013 lekë dhe

707,009 lekë. Këto teprica në mbyllje të viteve ushtrimore rakordojnë me listëpagesat e deklaruar në organet tatimore në sistemin C@ts.

### **1.3. Fondet Neto**

Nga auditimi u konstatua se Aktivet neto plotësojnë rregullin  $\text{Aktive} - \text{Pasive} = \text{Aktivet Neto}$  për periudhat objekt auditimi. Fondi i Konsoliduar përbëhet nga llog. 101 “Fondi i akumuluar” i cili sipas periudhave mbyllet respektivisht: Për vitin 2024 mbyllet me tepricë në shumën 594,927,699 lekë, për vitin 2023 është në shumën 659,442,348 lekë, për vitin 2022 është në shumën 766,697,688 lekë dhe për vitin 2021 është në shumën 767,449,196 lekë. Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” përfaqëson rezultatin e vitit ushtrimor përkatësisht për 2024 në shumën 25,330,288 lekë, për 2023 në shumën 34,896,947, për vitin 2022 në shumën 67,619,106 lekë dhe për vitin 2021 në shumën 88,880,460 lekë sipas tabelës 12 në aneks.

Nga auditimi i *Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto*, tepricat e llogarive në fund të periudhave ushtrimore pasqyrohen sipas tabelës 13 në aneks:

Nga auditimi materialit se totali fondeve neto në të dy pasqyrat rakordon por për tepricat e llogarisë 85 “*Nga Rezultatet e vitit ushtrimor*”, konstatohen mosrakordime. Për periudhën e mbyllur 2024 në dy pasqyrat e mësipërme rakordon, për periudhat e mbyllura 2023-2021 dy pasqyrat e mësipërme nuk rakordojnë. Mosrakordimi i së njëjtës llogari i pasqyruar me teprica të ndryshme për të njëjtën periudhë raportimi nuk na jep një pasqyrim të saktë dhe të drejtë të pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave.

Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit” përfaqëson fondet jashtë buxhetore të ngelura pranë Institucionit të cilat do të trashëgohen në vitin pasardhës. Kjo tepricë përfaqëson rezultatin nga funksionimi që institucionit i mbeten (sipas dispozitave ligjore) për t’u trashëguar në ushtrimet e mëpasme. Gjithashtu nga auditimi i pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” për vitin 2021 u **konstatua** se daljet jashtë përdorimi nuk janë pasqyruar në *Pasqyrës e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto* në shumën 107,657,515 lekë.

## **2. Pasqyra e Performancës**

Pasqyra e performancës financiare pasqyron në mënyrë të klasifikuar dhe strukturuar informacionin për të ardhurat, shpenzimet, transfertat dhe operacionet që lidhen me rezultatin financiar të periudhës ushtrimore të mbyllur të krahasuar me periudhën e vitit të mëparshëm.

Nga auditimi i gjendjes së llogarive në pasqyrën e performancës rezultoi se, konstatimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike ashtu edhe për ato analitike.

Totali i të “*Ardhurave*” në Pasqyrën e Performancës F2 është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit. Për vitin 2024 pasqyra paraqitet si më poshtë:

- a- Të ardhurat (grupi A) = 719,938,770 lekë
- b- Shpenzimet (grupi B) = 700,438,002 lekë
- c- Rezultati i ushtrimit (llog.85)= 19,500,768 lekë

Llogaria 85 “*Teprica ose deficitit i periudhës*“ në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1) rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132 të Formatit nr. 2 “*Pasqyra e Performancës*”.

Ndryshimi i gjendjes së llogarive të klasës 3 në Pasqyrën e pozicionit financiar në formatin F1 (diferenca midis tepricës më 31.12.2023 me 31.12.2024, përkatësisht 24,721,900 minus 21,329,162 konstatohet 3,392,738 lekë. Kjo vlerë konstatohet e barabartë me tepricën e llogarisë 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Pasqyrën nr. 2, “Pasqyra performancës financiare”.

## 2.1 Të ardhurat

Në kuptim të SKK1 Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës së raportimit, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e detyrimeve, si dhe që rrisin kapitalin e njësisë ekonomike...

Të ardhurat janë flukse hyrëse parash dhe përfaqësojnë rritjet e përfitimeve ekonomike bruto gjatë ushtrimit kontabël (periudhës së raportimit). Burim kryesor për të ardhurat në sektorin publik janë nga aktiviteti buxhetor, mallrat e shërbimet (veçori për sektorin publik). Gjithashtu, burime të tjera janë interesat, dividendët, grantet. Të ardhurat rrisin përfitimet ekonomike në formën e rritjes së aktiveve dhe pakësimit të pasiveve (detyrimeve), të cilat kanë për rezultat shtimin e fondeve të veta.

Nga auditimi i pasqyrës së performancës u konstatua se të ardhurat e realizuara gjatë viteve objekt auditimi janë rezultat i të ardhurave jotatimore dhe granteve korrente sipas të dhënave të tabelës 14 në aneks:

Të ardhurat jotatimore janë rezultat i të ardhurave të krijuara nga ana e Fakultetit të Ekonomisë të kontabilizuara në llogarinë 7110 “*Tarifa administrative dhe rregullatore*” për tarifa shkollimi, tarifa regjistrimi, vërtetime, libreza e diploma si dhe sponsorizime.

Nga auditimi i rakordimit të Të ardhurave dytësore u **konstatua** se kemi mospërputhje midis shumave të paraqitura në pasqyrën e performancës dhe shumave të paraqitura nga pasqyra e thesarit, konkretisht për vitin 2024 në pasqyrën e thesarit “*Të ardhura jotatimore*” paraqiten në shumën 172,818,888 lekë, ndërsa në pasqyrën e performancës paraqiten në shumën 224,318,194 lekë me një diferencë prej 51,499,306 lekë, për vitin 2023 në pasqyrën e thesarit “*Të ardhura jotatimore*” paraqiten në shumën 208,880,967 lekë, ndërsa në pasqyrën e performancës paraqiten në shumën 232,726,425 lekë, pra me një diferencë prej 23,845,458 lekë, për vitin 2022 kemi një mosrakordim në shumën 77,109,771 lekë ndërsa për vitin 2021 nuk është bërë rakordim me degën e thesarit lidhur me totalin vjetor të të ardhurave të pasqyruara në tabelën nr. 15 në aneks, të cilat kanë ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të strukturës së të ardhurave.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” pika 37, ku citohet: “*Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, para përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor, janë të detyruara të rakordojnë, vetëm për të dhënat mbi bazë Cash, me degën e thesarit të juridiksionit që i mbulon. Sipas procedurave të sistemit të thesarit, ato rakordojnë të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës ushtrimore, duke nënshkruar në dokumentin e akt-rakordimit apo situacionin e të ardhurave e shpenzimeve për vitin që raportohet. Rakordimi me sistemin e thesarit është i detyrueshëm për të dy palët*”.

Grantet korrente përbëhen nga financimet nga buxheti

- Llogaria 7200 “*Nga buxheti për NJQP (Qendrore)*” përfaqëson financimin me grante nga buxheti i shtetit për funksionimin e institucionit respektivisht për vitin 2024 në shumën 452,289,612 lekë, për vitin 2023 në shumën 425,267,865 lekë, për vitin 2022 në shumën 363,002,904 lekë dhe për vitin 2021 në shumën 384,671,293 lekë.

- Llogaria 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” përfaqëson shumën që institucioni u detyrohet punonjësve për pagat, detyrimet ndaj shtetit për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimin e mbajtur për tatimin mbi pagat për secilën periudhë objekt auditimi. Këto shuma rakordojnë me detyrimet afatshkurtra të pasqyruara në pasqyrën e pozicionit financiar të secilit vit financiar objekt auditimi.

## 2.2 *Shpenzimet*

Shpenzimet përfaqësojnë pakësim të përfitimeve ekonomike gjatë ushtrimit kontabël, në formën e daljes apo të pakësimit të vlerave të aktiveve apo rritjen e detyrimeve. Shpenzimet janë flukse dalëse gjatë periudhës raportuese, që kanë për rezultat zvogëlimin e kapitaleve të veta (fondeve), përfaqësojnë investimin që kryen njësia e qeverisjes së përgjithshme për realizimin e synimeve të tij të funksionimit gjatë një viti ushtrimor. Ato njihen në të njëjtën periudhë ushtrimore. Shpenzimet e raportuara për periudhat objekt auditimi pasqyrohen në tabelën 16 në aneks:

I. Llogaria 600 “*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*” përfaqëson pagat e personelit të përhershëm dhe të përkohshëm sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesa të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatimeve C@ts.

II. Llogaria 601 “*Kontribute të Sigurimeve*” përfaqëson shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e kontributeve e paguar nga punëdhënësi sipas detyrimeve të konstatuara dhe listëpagesave të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatimeve C@ts.

III. Llogaria 602 “*Blerje mallra e shërbime*” përfaqëson shpenzimet operative të kryera nga institucioni në funksion të aktiviteteve, u konstatua se nuk ka diferenca mes shpenzimeve të deklaruara në pasqyrat financiare dhe rakordimit me degën e thesarit për këtë zë sipas të dhënave të tabelës 17 në aneks:

Për vitin 2024 shpenzimet për mallra dhe shërbime janë klasifikuar sipas nënllogarive të klasës 602 si më poshtë:

a) Llogaria 6022 “*Shërbime nga të tretë*” për 11,518,628 lekë përbëhet nga shpenzime për shërbime utilitare si energji elektrike, ujë, shërbim telefoni/internet, shërbime postare,

b) Llogaria 6024 “*Shpenzime udhëtimi*” në shumën 27,500 lekë përbëhet nga shpenzime për dieta. Kontabilizimi i drejtë do të ishte në llogarinë 6009 “*Shpenzime të tjera për personelin*” sipas UMF nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*”

c) Llogaria 6025 “*Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme*” në shumën 120,000 lekë përfaqëson shpenzime për shërbime mirëmbajtje.

d) Llogaria 6026 “*Shpenzime për qiramarrje*” në shumën 540,000 lekë përfaqëson shpenzimet për qiramarrje ambientesh.

e) Llogaria 6029 “*Shpenzime të tjera operative*” në shumën 8,360,652 lekë përfaqëson shpenzime të ndryshme nga të cilat konstatohen keqklasifikime si: Shpenzimet për grupin i punës për pjesëmarrjen në komisionin e përhershëm të dhenies së gradës "Doktor" në shumën 367,984 lekë janë keqklasifikuar, kontabilizimi i drejtë do të ishte në nënllogarinë 6009 “*Shpenzime të tjera për personelin*”. Shpenzimet “*Pagesë për shërbime blerje antivirus, për fakultetin e Ekonomisë*” në shumën 119,724 lekë duhet të kontabilizoheshin në llogarinë 203 “*Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme*”. Shpenzimet “*Pagese për shërbime me projeksione Dep. Ekonomiksit për Konferencën Shkencore të FEUT*”, “*Pagese për shërbime prezantime në Led Ëall për Konferencën Shkencore të FEUT*”, “*Pagese për shërbime interaktive online për Konferencën Shkencore të FEUT*”, “*Pagese shërbime mirëmbajtje teknike, Buckaps, Website për feut.edu.al për Fakultetin e Ekonomisë,*” etj., në shumën 1,977,700 lekë duhet të ishin kontabilizuar në nënllogarinë 6022 “*Shërbime nga të tretë*”. Shpenzimet për mirëmbajtje të ndryshme në shumën 1,526,100 lekë si shërbime për ashensorin, shërbime utilitare të ndryshme, shërbime emergjence sistemi/rrjeti elektrik, kompjuterik në raste të paparashikuara në FEUT, shërbime bravandreqës/marangozi, materjale për sallat dhe zyrat e FE-UT, zhbllokim tubacione

duhet të kontabilizoheshin në nënllogarinë 6025 “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme”. Keqklasifikimet e mësipërme nuk janë në zbatim të UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, si dhe “Nomenclaturës së klasifikimit ekonomik kontabël”.

IV. Llogaria 6041 “Transferime korrente tek institucione qeveritare të ndryshme” në shumën prej 25,000,000 lekë përfaqëson transfertë për Rektoratin.

V. Llogaria 6061 “Transferta të paguara nga Inst. Tjera e Org. Pusht. Vendor” në shumën prej 93,625,078 lekë përfaqëson pagesa për bursat në shumën 90,510,000 lekë si dhe mbështetje financiare në shumën 3,114,678 leke për shpërblime për dalje në pension, për fatkeqësi mbështetje financiare etj.

VI. Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruara drejtë në shumën prej 3,392,738 lekë.

#### ▪ **Pasqyra e flukseve monetare (cash flow)**

Pasqyra financiare e flukseve monetare jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme. Nga auditimi i Pasqyrës së flukseve monetare për periudhën objekt auditimi u konstatua se nuk ka diferencë mes të hyrave nga sponsorizimet nga të tretët dhe rakordimeve me thesarin lidhur me grantet e disbursuara gjatë periudhës ushtrimore.

#### ▪ **Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto**

Nga auditimi i “Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto” u konstatua se të dhënat e kësaj pasqyre rakordojnë në total të dhënash me të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C, por u konstatua se në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto llogaria 85 “Nga rezultatet e vitit ushtrimor” nuk kuadron me llogarinë 85 “Nga rezultatet e vitit ushtrimor” në pasqyrën e pozicionit financiar me një diferencë prej 37,856,180 për vitin 2023, për vitin 2022 në shumën 441,350 lekë dhe 860,992 lekë për vitin 2021.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimi i MF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

#### **Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël**

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MF, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se Fakulteti i Ekonomisë ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...”

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë i aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustifikuara, është audituar periudha 2021-2024.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi, është realizuar procesi i inventarizimit sipas parashikimeve të Paragrafit nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se: “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”.

Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Hyrja e aktiveve në përgjithësi është dokumentuar me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve në përgjithësi është realizuar konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

### **Inventarizimi i vitit 2021:**

Me urdhrin e Administratorit nr. Prot. 1214 datë 29.12.2021 është urdhëruar ngritja e komisionit për inventarizimin periodik të vlerave materiale (materiale, mallra, pajisje) me përbërje: D. L, V. C. dhe I. L.. Afati i procedurave të inventarizimit fizik është deri në 31.12.2021. Materiali i përgatitur të dorëzohet pranë Administratorit dhe në Degën e Financës.

Me urdhrin e Administratorit nr. Prot. 716/1 datë 17.09.2021 është urdhëruar ngritja e komisionit për konstatimin e aktiveve pajisje elektronike që janë jo funksionale dhe të riparueshme me përbërje D. K. specialist i degës së shërbimeve, I. L. specialist i degës së shërbimeve dhe K. H. specialiste e degës së IT.

Me urdhrin e Administratorit nr. Prot. 716/2 datë 20.09.2021 është urdhëruar ngritja e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve (pajisje elektronike) që nuk punojnë dhe që janë të riparueshme me përbërje Y. C. kryetare e degës së IT, D. L. specialist i degës së shërbimeve dhe V. C. specialiste e financës dhe buxhetit.

Me urdhrin e Administratorit nr. Prot. 716/1 datë 17.09.2021 është urdhëruar ngritja e komisionit për dorëzimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në FE-UT me përbërje K. C. kryetare e degës së shërbimeve, E. K. specialiste e degës së financës dhe buxhetit dhe M. H. magazinierë.

### Procedura e ndjekur nga komisionet respektive është si vijon:

Nga auditimi i procedurës së inventarizimit u **konstatua** se nga grupi i inventarizimit nuk është hartuar raport lidhur me procesin e inventarizimit në zbatim të pikës 85 pika c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Janë dorëzuar vetëm tabelat e aseteve të nga të cilat nuk evidentohen diferenca mes gjendjeve kontabël dhe atyre fizike. Gjithashtu u konstatua se regjistri i aseteve nuk është i plotë pasi vlera e aseteve të inventarizuara nuk përputhet me vlerën e aseteve të kontabilizuara dhe të pasqyruara në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore.

Me proces-verbalin, akt-konstatimin datë 20.09.2021 në zbatim të urdhrin nr. 716/1 datë 17.09.2021 të administratorit komisioni i ngritur nuk ka hartuar raport në zbatim të pikës 85 pika c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Me proces-verbalin, akt-konstatimin datë 29.09.2021 në zbatim të urdhrin nr. 716/2 datë 20.09.2021 të administratorit komisioni i ngritur nuk ka hartuar raport në zbatim të pikës nr. 103,

104, 106 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu u konstatua se urdhri për ngritjen e grupit i ngritur për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve (pajisje elektronike) që nuk punojnë dhe që janë të riparueshme nuk është në zbatim të pikës nr. 100 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Me proces-verbalin, akt-konstatimin datë 31.12.2021 në zbatim të urdhrin nr. 716/1 datë 17.09.2021 të administratorit komisioni i ngritur ka bërë dorëzimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në zbatim të kontratës me objekt “Për dërgimin për trajtim, asgjësim të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në Universitetin e Tiranës”. Në vijim të këtij proces-verbali dokumentohet edhe gjurma e auditimit në zbatim të pikës 109 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

### **Inventarizimi i vitit 2022:**

Me urdhrin e Administratorit nr. Prot. 1735 prot datë 30.12.2022 është urdhëruar ngritja e komisionit për inventarizimin periodik të vlerave materiale (materiale, mallra, pajisje) me përbërje: K. M., D. L. dhe V. C. Materiali i përgatitur të dorëzohet pranë Administratorit dhe në Degën e Financës. Afati i procedurave të inventarizimit fizik është deri në 31.12.2022. Materiali i përgatitur të dorëzohet pranë Administratorit dhe në Degën e Financës.

#### Procedura e ndjekur nga komisionet respektive është si vijon:

Nga auditimi i procedurës së inventarizimit u **konstatua** se nga grupi i inventarizimit nuk është hartuar raport lidhur me procesin e inventarizimit në zbatim të pikës 85 pika c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu u konstatua se nga grupi i inventarizimit nuk është bërë inventarizimi i të gjithë asteve që fakulteti ka nën administrim dhe të pasqyruar në kontabilitet, si rrjedhojë vlera e aseteve në dosjen e inventarizimit është me e vogël sesa vlera e aseteve të kontabilizuara dhe të pasqyruara në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore.

Mos inventarizimi i plotë i aseteve është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” si dhe Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

### **Inventarizimi i vitit 2023**

Me urdhrin e administratorit nr. Prot. 1974 datë 29.12.2023 është urdhëruar ngritja e komisionit për inventarizimin periodik të vlerave materiale (materiale, mallra, pajisje) me përbërje K. M., D. L. dhe V. C.. Afati i procedurave të inventarizimit fizik është deri në 31.12.2023. Materiali i përgatitur të dorëzohet pranë Administratorit dhe në Degën e Financës.

Me urdhrin e Administratorit nr. Prot. 743 datë 10.05.2023 është urdhëruar ngritja e komisionit për konstatimin e aktiveve inventar ekonomik që janë jo funksionale dhe të riparueshme me përbërje: E. I. specialiste finance, D. L. specialist i degës së shërbimeve dhe K. T. specialiste e degës së shërbimeve.

Me urdhrin e Administratorit nr. Prot. 743/1 datë 05.09.2022 është urdhëruar ngritja e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve inventar ekonomik që janë jo funksionale dhe të riparueshme me përbërje: V. C. specialiste e financës, K. N. specialiste e degës së shërbimeve dhe N. P. specialist i degës së shërbimeve.

#### Procedura e ndjekur nga komisionet respektive është si vijon:

Nga auditimi i procedurës së inventarizimit u **konstatua** se nga grupi i inventarizimit nuk është hartuar raport lidhur me procesin e inventarizimit në zbatim të pikës 85 pika c të UMF nr. 30,

datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu u konstatua se nga grupi i inventarizimit nuk është bërë inventarizimi i të gjithë asteve që fakulteti ka nën administrim dhe të pasqyruar në kontabilitet, si rrjedhojë vlera e aseteve në dosjen e inventarizimit është me e vogël sesa vlera e aseteve të kontabilizuara dhe të pasqyruara në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore.

Me proces-verbalin, akt-konstatimin datë 04.09.2021 në zbatim të urdhrin nr. 743 datë 10.05.2023 të administratorit, komisioni i ngritur nuk ka hartuar raport në zbatim të pikës 85 pika c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” por ka dorëzuar vetëm listën e konstatuar me asete jofunksionale dhe të riparueshme.

Me proces-verbalin, akt-nxjerrje jashtë përdorimi datë 31.10.2023 në zbatim të urdhrin nr. 743/1 datë 05.09.2023 të administratorit komisioni i ngritur nuk ka hartuar raport në zbatim të pikës nr. 103, 104, 106 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu u konstatua se urdhri për ngritjen e grupit, i ngritur për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve inventar ekonomik që nuk punojnë dhe që janë të riparueshme nuk është në zbatim të pikës nr. 100 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Në vijim të këtij procesi nuk dokumentohet gjurma e auditimit në zbatim të pikës 109 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Në lidhje me procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve të njësisë, pas auditimit të dokumentacionit justifikues të vendosur në dispozicion nga ana e institucionit u konstatua: gjurmë jo e plotë e auditit përsa i përket procesit të asgjësimit.

### **Inventarizimi i vitit 2024**

Me urdhrin e administratorit nr. Prot. 1876 datë 31.12.2024 është urdhëruar ngritja e komisionit për inventarizimin periodik të vlerave materiale (materiale, mallra, pajisje) me përbërje: K. M., D. L. dhe V. C. Afati i procedurave të inventarizimit fizik është deri në 31.12.2024 Materiali i përgatitur të dorëzohet pranë Administratorit dhe në Degën e Financës.

Procedura e ndjekur nga komisionet respektive është si vijon:

Nga auditimi i procedurës së inventarizimit u **konstatua** se nga grupi i inventarizimit nuk është hartuar raport lidhur me procesin e inventarizimit në zbatim të pikës 84 dhe 85 (c) të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu u konstatua se nga grupi i inventarizimit nuk është bërë inventarizimi i të gjithë asteve që fakulteti ka nën administrim dhe të pasqyruar në kontabilitet, si rrjedhojë vlera e aseteve në dosjen e inventarizimit është me e vogël sesa vlera e aseteve të kontabilizuara dhe të pasqyruara në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore. Mos inventarizimi i plotë i aseteve është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” si dhe Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

### **Magazina qendrore**

Magazina qendrore brenda institucionit të Fakulteti i Ekonomisë.

Nga auditimi i magazinës u konstatua se:

- 1-Procesi i hyrje-daljeve nga magazina mbahet me fletë hyrje dhe fletë dalje.
- 2- Dalja e inventarit nga magazina bëhet për çdo kërkesë për tërheqje malli.
- 3-Kontabilizimi i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve bëhet në fund të vitit ushtrimor, duke mos dhënë të dhëna të sakta në çdo moment lidhur me gjendjen e magazinës.

Veprimet e mësipërme nuk janë kryer në zbatim të Udhëzimit nr. 30 të MF, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 37 ku citohet: “Hyrja e

*aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë)”.*

Observacion i subjektit nr. 620/7 prot., datë 31.07.2025 mbi projekt raportin e auditimit në FGJH-UT, datë 04.07.2025, protokolluar në KLSH me nr. 103/34 prot., datë 01.08.2025.

**Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me gjetjet e pikës nr. 6 dhe rekomandimi nr. 6.1, përsa i përket gjetjeve të grupit auditues, ju informojmë se, Fakulteti i Ekonomisë bazuar në Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 (i ndryshuar) "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", bën në mënyrën më të saktë deklarin e ngarkesave dhe mbingarkesave në formularë dhe evidenca analitike të çdo lloji veprimtarie mësimore në auditor dhe jashtë auditorit. Sipas përcaktimeve në kreun e II "Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik në IAL", deklarohet në formularin e çdo punonjësi staf akademik i "brendshëm" sipas Gjurmës standarde të Auditit dhe mbi të reklamohet çdo element i veprimtarisë bazuar në pikën nr. 3 të kreut të I si dhe në zbatim të pikës 1 të Kreut të III që parashikon se çdo anëtar i stafit akademik i punësuar me kohë të plotë pranë IAL duhet të përmbushë detyrimet vjetore të punës prej 1536 orë në vit. Vlerësojmë se rekomandimi nr. 6.1 është në tejkalim të kompetencave për arsye se gjetjet bien ndesh me Ligjin nr. 80/2015 dhe rekomandimi është i pa mbështetur në udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 (i ndryshuar).

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Përsa i përket observimeve të paraqitura lidhur me mos pasqyrimin e detajuar të të dhënave nga "kërkimi shkencor", "kontributi institucional", dhe "kontributi profesional" në formularin e veprimtarisë mësimore vlerësojmë se ato nuk përkojnë me problematikën e ngritur. Ju konfirmojmë edhe një herë se problematika e konstatuar vjen në kundërshtim me Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 (i ndryshuar) "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" pika 4 germa c) e në vijim të Kreut I "Veprimtaria që kryen Personeli Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë"

Përsa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Observacion i subjektit nr. 620/7 prot., datë 31.07.2025 mbi projekt raportin e auditimit në FGJH-UT, datë 04.07.2025, protokolluar në KLSH me nr. 103/34 prot., datë 01.08.2025.

**Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me gjetjet e pikes nr. 7 dhe rekomandimi nr. 7.1, përsa i përket gjetjeve të grupit auditues, ju informojmë se, Fakulteti i Ekonomisë- UT, mbështetur në Ligjin 80/2015 dhe bazuar në udhëzimin nr. 29, date 10.09.2018 (i ndryshuar) "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", bën në mënyrë korrekte deklarin e punonjësve/stafit në organet tatimore një ditë përpara (ref. Akteve në fuqi në R.Sh). Përsa i përket stafit personeli akademik i jashtëm i ftuar, bazuar në ligjin nr. 9920, date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", deklarimi i tyre bëhet në momentin që kryhet pagesa për ngarkesën mësimore sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 (i ndryshuar).

Vlerësojmë se rekomandimi nr. 7.1 në lidhje me stafin me kohë të plotë (akademik apo ndihmës dhe administrativ) dhe atë jo akademik me kontratë nuk konstaton në një gjetje reale (pra është plotësisht i zbatuar nga ana e fakultetit), Ky rekomandim është tërësisht subjektiv dhe nuk gjen zbatim në procedurat e deklarinimit sipas përcaktimeve që parashikojnë ligjet dhe aktet nënligjore

në fuqi për stafin akademik me kontratë me kohë të pjesshme (i jashtëm/i ftuar), Në respektim të këtij rekomandimi mbetemi në pritje të Raportit Përfundimtar nëse do na orientoni se si mund të deklarohet një punonjës me kontratë staf akademik me kohë të pjesshme i jashtëm/i ftuar një ditë përpara pasi është lidhur kontrata me titullarin e institucionit arsimor për ngarkesën mësimore simestrale ose vjetore.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Përsa i përket observimeve të paraqitura lidhur me mos deklarimin në kohë të punonjësve me kohë të pjesshme në organet tatimore sipas përcaktimeve ligjore përkatëse nuk justifikojnë problematikën e konstatuar. Siç janë trajtuar edhe në projekt raport problematikat vijnë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përsa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Observacion i subjektit nr. 620/7 prot., datë 31.07.2025 mbi projekt raportin e auditimit në FGJH-UT, datë 04.07.2025, protokolluar në KLSH me nr. 103/34 prot., datë 01.08.2025.

**Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me gjetjet e pikes nr. 8 dhe rekomandimi nr. 8.1, përsa i përket gjetjeve të grupit auditues, ju informojmë se, Fakulteti i Ekonomisë- UT, përsa më sipër referoheni, vepron në respektim të nenit 3 pika c, 9; nenit 6; nenit 98 të Ligjit 80/2015 për IAL. Sikurse ju informuam gjatë periudhës së auditimit dhe ju vumë në dispozicion listat me debitorë, evidentuat se në Fakultetin e Ekonomisë, jo vetëm për periudhën objekt auditimi por dhe me herët, nuk rezulton qoftë dhe një student që të jetë debitor dhe të ketë tërhequr kartonin e diplomës apo të jetë pajisur me vërtetim diplomimi dhe lista notash përfundimtare pa likuiduar më parë detyrimet, këtë fakt e përforcojmë dhe me procedurën që ndjekim dhe me bllokimin e çregjistrimit të studenteve nëse figurojnë debitorë, duke mos i bllokuar derisa të likuidojnë të gjitha detyrimet.

Vlerësojmë se rekomandimi nr. 8.1 në lidhje me identifikimin dhe verifikimin e studenteve debitorë është procedure e konsoliduar ndër vite sikurse ju rekomandoni. Përsa i përket kantabilizimit të detyrimeve në pasqyrat financiare, jemi të paqartë se ku bazohet kjo mënyrë aplikimi, ndaj mbetemi në pritje të raportit përfundimtar nga ana juaj se si mund të procedohet për tu zbatuar ky rekomandim.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Përsa i përket observimeve të paraqitura lidhur me mos kontabilizimin dhe mos pasqyrimin si të Drejta në Pasqyrat Financiare, të detyrimeve financiare që kanë studentët ndaj Fakultetit, ato nuk justifikojnë problematikën e konstatuar. Siç është trajtuar edhe në projekt raport problematikat vijnë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Përsa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Observacion i subjektit nr. 620/7 prot., datë 31.07.2025 mbi projekt raportin e auditimit në FGJH-UT, datë 04.07.2025, protokolluar në KLSH me nr. 103/34 prot., datë 01.08.2025.

**Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me gjetjet e pikës nr. 10 dhe rekomandimi nr. 10.1, te grupit auditues, ju informojmë se, Fakulteti i Ekonomisë-UT, ndërvepron vetëm me një Institucion (Degën e Thesarit të Tiranës) konform udhëzimit nr. 8, date 09.03.2018 të MF i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21. 02.2022 të MFE.

Vlerësojmë se rekomandimi nr. 10.1 është me tepër një rekomandim në rang Institucioni (Rekatorati) për faktin se si njësi shpenzuese FE-UT ndërvepron vetëm me Degën e Thesarit të Tiranës.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Përsa i përket observimeve të paraqitura lidhur me mos rakordimin e të ardhurave dytësore të pasqyruara në pasqyrat financiare dhe atyre të pasqyruara në raportet e thesarit, ato nuk justifikojnë problematikën e konstatuar. Siç është trajtuar edhe në projektraport problematikat janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar.

Përsa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Observacion i subjektit nr. 620/7 prot., datë 31.07.2025 mbi projekt raportin e auditimit në FGJH-UT, datë 04.07.2025, protokolluar në KLSH me nr. 103/34 prot., datë 01.08.2025.

#### **Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me gjetjet e pikës nr. 11 dhe rekomandimi nr. 11.1, të grupit auditues, konstatojmë se gjetjet janë pa patur një indeks sasior. Fakulteti i Ekonomisë-UT, pasqyron shpenzimet e kryera në zbatim të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 të MF i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 të MFE

Vlerësojmë se rekomandimi nr. 11.1 është shumë cilësor dhe specifik duke marrë në konsideratë dinamikën brenda Fakultetit. Në respektim të Rekomandimit tuaj në Raportin Përfundimtar, Ju lutemi të na orientoni konkretisht se si duhet të procedojmë dhe çfarë duhet të bëjmë për të përmirësuar pasqyrimin sa më saktë të shpenzimeve të kryera dhe klasifikimit të tyre.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Përsa i përket observimeve të paraqitura lidhur me keqklasifikimet e transaksioneve në llogari jo të sakta, ato nuk justifikojnë problematikën e konstatuar. Siç është trajtuar edhe në projektraport problematikat janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar.

Përsa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Observacion i subjektit nr. 620/7 prot., datë 31.07.2025 mbi projekt raportin e auditimit në FGJH-UT, datë 04.07.2025, protokolluar në KLSH me nr. 103/34 prot., datë 01.08.2025.

#### **Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me gjetjet e pikës nr. 12 dhe rekomandimi nr. 12.1, të grupit auditues, ju informojmë se Administrotori i Fakultetit është nëpunës autorizues dhe në lidhje me inventarizimin zbatohet Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" (i zhornuar me udhëzimin nr. 20 datë 17.11. 2014, Udhëzimin nr. 1 datë 06.05.2016 dhe Udhëzimin nr. 24 datë 07. 12.2016), si dhe të nenit 6, gërma "e" të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ministri i Financave. Administratori mund të urdhërojë vetëm specialistët e fushës së financës dhe strukturat e tjera administrative.

Vlerësojmë se rekomandimi nr. 12.1 del përtej kompetencës së Administratorit të Fakultetit. Në respektim të Rekomandimit tuaj në Raportin Përfundimtar, Ju lutemi të na udhëzoni më konkretisht me reference ligjore në mënyrë që ky rekomandim të gjejë zbatim në të gjitha nivelet dhe strukturat e fakultetit.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Përsa i përket observimeve të paraqitura lidhur me problematikat e konstatuara mbi procesin e

inventarizimit të pronës shtetërore, ato nuk justifikojnë problematikën e konstatuar. Siç është trajtuar edhe në projektraport problematikat janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Përsa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

## **2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, shërbimeve dhe mallrave**

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër pika 1, nënpika 5, u auditua *planifikimi dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, shërbimeve dhe mallrave.*

Për auditimin e kësaj pike u kërkua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2021-31.12.2024;
  - Dokumentacioni i OE, shpallur fitues, paraqitur në sistemin elektronik të APP;
  - Dosja e procedurës së prokurimit sipërcituar;
  - Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP-së;
  - Përlllogaritja e fondit limit.
- **Për vitin 2021**, janë parashikuar 38 procedura prokurimi dhe janë zhvilluar 19 procedura prokurimi “Blerje me vlerë të vogël” me shumën totale të fondit limit në vlerën 8,933,334 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate prej 6,455,396 lekë pa TVSh, me një diferencë nga fondi limit në vlerën 2,477,938 lekë ose 72%.
- **Për vitin 2022**, janë parashikuar 35 procedura prokurimi dhe janë zhvilluar 30 procedura prokurimi “Blerje me vlerë të vogël”, me shumën totale të fondit limit në vlerën 8,495,502 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate 5,856,040 lekë pa TVSh, me një diferencë nga fondi limit prej 2,639,462 lekë ose 69 %.
- **Për vitin 2023**, janë parashikuar 35 procedura prokurimi dhe janë zhvilluar 14 procedura prokurimi me vlerë të vogël, me shumën totale të fondit limit në vlerën prej 6,555,835 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate 4,664,900 lekë pa TVSh, me një diferencë nga fondi limit prej 1,890,935 lekë ose 71%.
- **Për vitin 2024**, janë parashikuar 34 procedura prokurimi dhe janë zhvilluar 9 procedura prokurimi me vlerë të vogël, me shumën totale të fondit limit në vlerën prej 5,375,001 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate 4,198,500 lekë pa TVSh, me një diferencë nga fondi limit prej 1,176,501 lekë ose 78%.

Nga auditimi u konstatua se, nga numri i procedurave të parashikuara në regjistrin e parashikimit për secilin vit, si dhe numrit të procedurave të realizuara u konstatua se, procesi i planifikimit paraqet mangësi në aspektin e një parashikimi jo real, pasi për periudhën e audituar, nga ana e subjektit është realizuar 50% për vitin 2021 nga numri total dhe për vitin 2022 është realizuar 86%, për vitin 2023 është realizuar 40%, ndërsa për vitin 2024 është realizuar 26% nga numri total i procedurave të planifikuara në regjistër, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 3, pika 2 të Kreut II, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe pikës 1 të Udhëzimit nr.04, datë 18.6.2021, të APP-së “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të

*prokurimit dhe krijimit të tyre në SPE”.*

### **Për vitin 2021**

Është ngritur Komisioni për Blerjet e Vogla me Urdhër nr. 308/1 prot., datë 10.05.2021 të Administratorit të Fakultetit Ekonomik, z. E. H., me përbërje si vijon: D. K., Kryetar, V. F. dhe E. Xh., Anëtar.

### **Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të kryera nga Fakultetit Ekonomik, rezultoi se:**

Me *urdhër prokurimi nr. 10, datë 22.11.2021*, me objekt “shërbim coffee break për 300 persona” me shkresë pa numër protokoll në datë 22.11.2021 të llogaritjes së fondit limit, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 297,000 lekë pa TVSh. U konstatua se mosprotokollimi i dokumenteve të prokurimit është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, pikën 17, të Udhëzimit nr.5 datë 25.06.2021 “*Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, si dhe nenet 17, 18 dhe 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.* Gjithashtu u konstatua se për llogaritjen e fondit limit janë marrë për referencë 3 OE, ku OE “G. ShPK” rezulton se nuk ka në fushën e veprimtarisë shërbimin i cili po prokurohet, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 76, pika 2. Në kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë nga ana e Komisionit për Blerje të Vogla datë 22.11.2021 nuk kërkohet paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit nga operatorët ekonomik, veprime në kundërshtim nenin 82 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 25, dhe 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Rezulton të jetë hartuar Urdhërit pa numër, datë 22.11.2021 “Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim” e më pas shoqëruar me proces verbal marrje në dorëzim pa numër, datë 26.11.2021. Bashkëlidhur, fatura nr. 91, datë 29.11.2021, me Urdhër Shpenzimin nr. 283, datë 16.12.2021 është likuiduar subjekti subjekti “H. G.” për vlerën 164,639 lekë.

### **Për vitin 2022**

Është ngritur Komisioni për Blerjet e Vogla me Urdhër nr. 475/1 prot., datë 14.04.2022 të Administratorit të Fakultetit Ekonomik, z. E. H., me përbërje si vijon: D. K., Kryetar, E. K. dhe E. Xh., Anëtar. Me shkresën Nr.475/4 prot., datë 13.09.2022, është përcjellë nga FE-UT kërkesa për zëvendësimin e njëjës prej anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, pasi ka ndërpresë marrëdhëniet e punës me fakultetin. FE-UT në kërkesë propozon z. N. P. dhe kërkon krijimin e llogarisë në sistemin e prokurimeve. Me shkresën Nr.475/5 prot., datë 16.09.2022 Universiteti i Tiranës dërgon llogarinë e përdoruesit të ri në komisionin e blerjeve të vogla në FEUT.

### **Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të kryera nga Fakultetit Ekonomik, rezultoi se:**

Me shkresë pa numër, datë 10.05.2022 është bërë kërkesë për shërbime Led Wall për Fakultetin e Ekonomisë UT, me *urdhër prokurimi nr. 9, datë 11.05.2022*, me objekt “shërbim në projektion, Led Wall në aktivitete shkencore” me shkresë pa numër protokoll në datë 11.05.2022 të llogaritjes së fondit limit, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 750,000 lekë pa TVSh. U konstatua se mosprotokollimi i dokumenteve të prokurimit është në kundërshtim me

nenin 24 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, pikën 17, të Udhëzimit nr.5 datë 25.06.2021 “*Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*, si dhe nenet 17, 18 dhe 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu u konstatua se OE fitues ka përcjellë dokumentacionin protokolluar në Fakultetin e Ekonomisë me nr. 624 prot., datë 16.05.2022, ndërsa në SPE njoftimi i fituesit është bërë nga KVO më datë 13.05.2022 dhe është konfirmuar si OE fitues më datë 14.05.2022 në kundërshtim me nenin 56, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë nga ana e Komisionit për Blerje të Vogla datë 12.05.2022 nuk kërkohet paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit nga operatorët ekonomik, veprime në kundërshtim nenin 82 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 25, dhe 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Lidhur me OE “S. A.”, rezultojnë se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK, pasi nuk ka përcjellë në FE dokumentacionin që kërkohet si vijon:

1. OE ofertues duhet të paraqesë vërtetim të shlyerjes së detyrimeve të OSHEE-së, pika 1 në ftesën për ofertë.
2. Kopje të certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin platformën Qendrore të Faturave, pika 5/2 në ftesën për ofertë. Në kundërshtim me nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Rezultojnë të jetë hartuar Urdhërit pa numër, datë 18.05.2022 “Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim” e më pas shoqëruar me proces verbal marrje në dorëzim pa numër, datë 11.06.2022. Bashkëlidhur, fatura nr. 224, datë 13.06.2022, me Urdhër Shpenzimit nr. 118, datë 06.07.2022 është likuiduar subjekti subjekti “S. A.” për vlerën 750,000 lekë.

### **Për vitin 2023**

Është ngritur Komisioni për Blerjet e Vogla me Urdhër nr. 600/1 prot., datë 24.04.2023 të Administratorit të Fakultetit Ekonomik, z. E. H., me përbërje si vijon: D. K., Kryetar, E. I. dhe K. T., Anëtar.

### **Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të kryera nga Fakultetit Ekonomik, rezultoi se:**

1. Me shkresë pa numër, datë 30.11.2023 është bërë kërkesë për shërbim transporti, me ***urdhër prokurimi nr. 12, datë 01.12.2023***, me objekt “shërbim transporti” me shkresë pa numër protokoll në datë 01.12.2023 të llogaritjes së fondit limit, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 260,000 lekë pa TVSh. U konstatua se mosprotokollimi i dokumenteve të prokurimit është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, pikën 17, të Udhëzimit nr.5 datë 25.06.2021 “*Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*, si dhe nenet 17, 18 dhe 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe aksesimi në SPE, u konstatua se klasifikimi përfundimtarë është bërë nga AK në ditë pushimi, me datë 09.12.2023, në kundërshtim me pikën 14 të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar. Gjithashtu u konstatua se për llogaritjen e fondit limit janë marrë për referencë 3 OE, ku OE “I. S.” rezultojnë pas verifikimit në QKB e ka fushën e veprimtarisë në

Burrel, pra jashtë Tirane, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 76, pika 2. Kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë nga ana e Komisionit për Blerje të Vogla është hartuar datë 05.12.2023 nuk kërkohet paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit nga operatorët ekonomik, veprime në kundërshtim nenin 82 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 25, dhe 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Rezulton të jetë hartuar Urdhërit pa numër, datë 07.12.2023 “Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim” e më pas shoqëruar me proces verbal marrje në dorëzim pa numër, datë 10.12.2023. Bashkëlidhur, fatura nr. 688, datë 10.12.2023, me Urdhër Shpenzimin nr. 234, datë 21.12.2023 është likuiduar subjekti subjekti “Z. T.” për vlerën 297,600 lekë.

2. Me shkresë pa numër, datë 30.11.2023 është bërë kërkesë për shërbim Coffee Break, me ***urdhër prokurimi nr. 14, datë 01.12.2023***, me objekt “shërbim Coffee Break” me shkresë pa numër protokoll në datë 01.12.2023 të llogaritjes së fondit limit, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 205,500 lekë pa TVSh. U konstatua se mosprotokollimi i dokumenteve të prokurimit është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, pikën 17, të Udhëzimit nr.5 datë 25.06.2021 “*Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, si dhe nenet 17, 18 dhe 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë*”. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe aksesimi në SPE, u konstatua se për llogaritjen e fondit limit janë marrë për referencë 3 OE, ku OE “I. S.” rezulton pas verifikimit në QKB e ka fushën e veprimtarisë në Burrel, pra jashtë Tirane, në kundërshtim me nenin 76, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë nga ana e Komisionit për Blerje të Vogla është hartuar datë 05.12.2023 nuk kërkohet paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit nga operatorët ekonomik, veprime në kundërshtim nenin 82 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 25, dhe 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Rezulton të jetë hartuar Urdhërit pa numër, datë 07.12.2023 “Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim” e më pas shoqëruar me proces verbal marrje në dorëzim pa numër, datë 10.12.2023. Bashkëlidhur, fatura nr. 689, datë 10.12.2023, me Urdhër Shpenzimin nr. 236, datë 21.12.2023 është likuiduar subjekti subjekti “Z. T.” për vlerën 228,000 lekë.

3. Me shkresë pa numër, datë 01.12.2023 është bërë kërkesë për shërbime të ndryshme me karakter elektronik, me ***urdhër prokurimi nr. 20, datë 11.12.2023***, me objekt “shërbime të ndryshme me karakter elektronik informatizues-digitalizues për konferencë shkrencore” me shkresë pa numër protokoll në datë 11.12.2023 të llogaritjes së fondit limit, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 702,667 lekë pa TVSh. U konstatua se mosprotokollimi i dokumenteve të prokurimit është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, pikën 17, të Udhëzimit nr.5 datë 25.06.2021 “*Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, si dhe nenet 17, 18 dhe 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë*”. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe aksesimi në SPE, u konstatua se për llogaritjen e fondit limit janë marrë për referencë 3 OE, ku 2 OE “Z. Sh.” dhe “A. B.” nuk kanë në fushën e veprimtarisë së tyre shërbimin live stream, në kundërshtim me nenin 76, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë nga

ana e Komisionit për Blerje të Vogla është hartuar datë 14.12.2023 nuk kërkohet paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit nga operatorët ekonomik, veprime në kundërshtim nenin 82 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 25, dhe 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Rezulton të jetë hartuar Urdhërit pa numër, datë 15.12.2023 “Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim” e më pas shoqëruar me proces verbal marrje në dorëzim pa numër, datë 16.12.2023. Bashkëlidhur, fatura nr. 8/2023, datë 18.12.2023, me Urdhër Shpenzimin nr. 239, datë 21.12.2023 është likuiduar subjekti “E. C.” për vlerën 630,000 lekë.

Gjatë auditimit, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u konstatua se konferenca ka filluar me datë 15-16 dhjetor, ndërkohë që procedura e prokurimit është hedhur në sistem në datë 14 dhjetor 2023 dhe është finalizuar me datë 17.12.2023 në SPE. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, u konstatua se është ngritur grupi i marrjes në dorëzim në datë 15.12.2023. Ky komision ka qenë i përbërë nga z. D. L., znj. K. C. dhe z. B. Gj., konfirmon realizimin me sukses të shërbimit të transportit të kërkuar dhe të specifikuar sipas ftesës për ofertë.

U konstatua se shërbimi ka filluar realizimin e tij dhe është bërë marrja në dorëzim nga grupi i ngritur përpara realizimit (mbylljes) me sukses në SPE të procedurës, duke mos respektuar afatin 2 ditor të pritjes së ankimeve. Kështu duke mos respektuar periudhën e pritjes për të marrë shërbimin, në kundërshtim me nenin 96 të LPP, Nr.162/2020 të ndryshuar, pasi nuk mund të nënshkruajë kontratën me fituesin e procedurës së prokurimit pa kaluar një periudhë e caktuar nga dita e publikimit të njoftimit të fitues, të paktën 2 ditë kalendarike në rastin e prokurimeve me vlerë të vogël.

4. Me shkresë pa numër, datë 01.12.2023 është bërë kërkesë për shërbim prezantime me Led Wall, me **urdhër prokurimi nr. 16, datë 06.12.2023**, me objekt “Shërbim prezantime me Led Wall” me shkresë pa numër protokoll në datë 06.12.2023 të llogaritjes së fondit limit, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 535,000 lekë pa TVSh. U konstatua se mosprotokollimi i dokumenteve të prokurimit është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, pikën 17, të Udhëzimit nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, si dhe nenet 17, 18 dhe 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë. Kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë nga ana e Komisionit për Blerje të Vogla është hartuar datë 07.12.2023 nuk kërkohet paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit nga operatorët ekonomik, veprime në kundërshtim nenin 82 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 25, dhe 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Rezulton të jetë hartuar Urdhërit pa numër, datë 12.12.2023 “Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim” e më pas shoqëruar me proces verbal marrje në dorëzim pa numër, datë 16.12.2023. Bashkëlidhur, fatura nr. 28, datë 19.12.2023, me Urdhër Shpenzimin nr. 240, datë 21.12.2023 është likuiduar subjekti “E. D.” për vlerën 588,000 lekë.

Gjatë auditimit, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u konstatua se konferenca ka filluar me datë 15-16 dhjetor, ndërkohë që procedura e prokurimit është hedhur në sistem në datë 14 dhjetor 2023 dhe është finalizuar me datë 17.12.2023 në SPE. Shërbimi ka filluar realizimin e tij dhe është bërë marrja në dorëzim nga grupi i ngritur përpara realizimit (mbylljes) me sukses në SPE të procedurës, duke mos respektuar afatin 2 ditor të pritjes së ankimeve. Kështu duke mos respektuar periudhën e pritjes por ka marrë shërbimin, kjo në kundërshtim me nenin 96 të LPP,

Nr.162/2020 të ndryshuar, pasi nuk mund të nënshkruajë kontratën me fituesin e procedurës së prokurimit pa kaluar një periudhë e caktuar nga dita e publikimit të njoftimit të fitues, të paktën 2 ditë kalendarike në rastin e prokurimeve me vlerë të vogël.

### **Për vitin 2024**

Është ngritur Komisioni për Blerjet e Vogla me Urdhër nr.449/1, datë 05.04.2024 të Administratorit të Fakultetit Ekonomik, z. E. H., me përbërje si vijon: D. K., Kryetar, E. I. dhe K. T., Anëtar.

### **Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të kryera nga Fakultetit Ekonomik, rezultoi se:**

1. Me **urdhër prokurimi nr. 10, datë 03.12.2024**, me objekt “Artikuj promocional për konferencën” me shkresë pa numër protokoll në datë 02.12.2024 të llogaritjes së fondit limit, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 499,000 lekë pa TVSh. U konstatua se mosprotokollimi i dokumenteve të prokurimit është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, pikën 17, të Udhëzimit nr.5 datë 25.06.2021 “*Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlere te vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, si dhe nenet 17, 18 dhe 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë*”. Si dhe në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, Komisioni i Prokurimit për Blerjet me Vlerë të Vogël ka kryer testim të tregut, dhe ka vendosur si vlerë fondi limit, çmimin më të ulët nga tre ofertat e marra dhe jo në bazë të mesatares së tre ofertave, në kundërshtim me parashikimin e nenit 76, pika 1, shkronja b) të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”. Në kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë nga ana e Komisionit për Blerje të Vogla datë 03.12.2024 nuk kërkohet paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit nga operatorët ekonomik, veprime në kundërshtim nenin 82 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, si dhe nenet 25, dhe 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”. Rezulton të jetë hartuar Urdhërit pa numër, datë 16.12.2024 “*Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim*” e më pas shoqëruar me proces verbal marrje në dorëzim pa numër, datë 16.12.2024, me fletë hyrje nr. 18, datë 16.12.2024. Bashkëlidhur, fatura nr. 20/2024, datë 16.12.2024, me Urdhër Shpenzimin nr. 248, datë 26.12.2024 është likuiduar subjekti “U. A. Shpk” për vlerën 495,600 lekë.

2. Me **urdhër prokurimi nr. 16, datë 03.12.2024**, me objekt “Shërbime interaktive online” me shkresë pa numër protokoll në datë 02.12.2024 të llogaritjes së fondit limit, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 693,000 lekë pa TVSh. U konstatua se mosprotokollimi i dokumenteve të prokurimit është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, pikën 17, të Udhëzimit nr.5 datë 25.06.2021 “*Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlere te vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, si dhe nenet 17, 18 dhe 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë*”. Në kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë nga ana e Komisionit për Blerje të Vogla datë 05.12.2024 nuk kërkohet paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit nga operatorët ekonomik, veprime në kundërshtim nenin 82 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, si dhe nenet 25, dhe 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”. Rezulton të jetë hartuar Urdhërit pa numër, datë 13.12.2024 “*Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim*” e më pas

shoqëruar me proces verbal marrje në dorëzim pa numër, datë 14.12.2024. Bashkëlidhur, fatura nr. 47/2024, datë 14.12.2024, me Urdhër Shpenzimin nr. 254, datë 26.12.2024 është likuiduar subjekti “E. C.” për vlerën 690,000 lekë.

3. Me **urdhër prokurimi nr. 17, datë 03.12.2024**, me objekt “Shërbime prezantimi për konferencë” me shkresë pa numër protokoll në datë 02.12.2024 të llogaritjes së fondit limit, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 740,000 lekë pa TVSh. U konstatua se mosprotokollimi i dokumenteve të prokurimit është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, pikën 17, të Udhëzimit nr.5 datë 25.06.2021 “*Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlere te vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, si dhe nenet 17, 18 dhe 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë*”. Në kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë nga ana e Komisionit për Blerje të Vogla datë 05.12.2024. Rezulton të jetë hartuar Urdhërit pa numër, datë 16.12.2024 “Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim” e më pas shoqëruar me proces verbal marrje në dorëzim pa numër, datë 16.12.2024. Bashkëlidhur, fatura nr. 183/2024, datë 10.12.2024, me Urdhër Shpenzimin nr. 255, datë 26.12.2024 është likuiduar subjekti “S. AD” për vlerën 510,000 lekë.

4. Me **urdhër prokurimi nr. 11, datë 03.12.2024**, me objekt “Blerje materiale konsumi” me shkresë pa numër protokoll në datë 02.12.2024 të llogaritjes së fondit limit, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 750,000 lekë pa TVSh. U konstatua se mosprotokollimi i dokumenteve të prokurimit është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, pikën 17, të Udhëzimit nr.5 datë 25.06.2021 “*Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlere te vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, si dhe nenet 17, 18 dhe 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë*”. Në kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë nga ana e Komisionit për Blerje të Vogla datë 03.12.2024 nuk kërkohet paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit nga operatorët ekonomik, veprime në kundërshtim nenin 82 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 25, dhe 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Rezulton të jetë hartuar Urdhërit pa numër, datë 10.12.2024 “Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim” e më pas shoqëruar me proces verbal marrje në dorëzim pa numër, datë 13.12.2024. Bashkëlidhur, fletë hyrja nr. 15, datë 13.12.2024, fatura nr. 5/2024, datë 13.12.2024, me Urdhër Shpenzimin nr. 249, datë 26.12.2024 është likuiduar subjekti “E. D.” për vlerën 778,200 lekë.

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën 2021-2024 veç problematikave të sqaruara specifikisht për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël si më lart, rezulton gjithashtu:

1. Moskryerja e inventarizimit dhe arkivimit të dokumentacionit të procedurave të prokurimit, në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, nenin 21 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, si dhe nenin 16, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar.

2. Për vitin 2021 dhe 2024 nuk është hartuar një kërkesë paraprake për fillimin e procedurës së Prokurimit në kundërshtim me nenin 2 pika 2 germa “a” dhe nenin 13 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: z. E. H., Administrator i Fakultetit të Ekonomisë; z. D. K.; znj. V. F.; znj. E. Xh.; znj. E. K.; znj. E. I.; znj. K. T., në cilësinë e Komisionit të Blerjeve të Vogla; Z. D. L.; znj. K. C.; z. B. Gj., në cilësinë e Komisionit të Marrjes në Dorëzim.*

Për sa është trajtuar në lidhje me pikën e mësipërme në Projekt Raportin e Auditimit, është paraqitur observacioni me nr. 620/7 prot., datë 31.07.2025, protokolluar në KLSh me nr. 103/34 datë 01.08.2025, nga z. E. H. me pozicion Administrator i Fakultetit të Ekonomisë, për të cilin japim sqarimet si më poshtë.

### **Pretendimi i subjektit:**

1. Në lidhje me gjetjet e pikës nr. 1 dhe rekomandimi nr. 1.1, përsa i përket faktit të konstatuar se janë realizuar mesatarisht 71% të procedurave të planifikuara, ju informojmë se kjo mesatare është e vlerësuar prej periudhës së kryerjes së auditimit për vitet buxhetore 2021-2024. Në vitin 2021 mosrealizimi ka ardhur për faktin e Pandemisë (covid19) dhe për këtë arsye FE-UT ka realizuar një numër shumë të ulët me afërsisht 55% të mesatares së procedurave çka ka dhënë efekt zinxhir në vitet që pasuan por dhe ka ndikuar në realizimin mesatarisht prej 71% të tyre.
2. Në lidhje me gjetjet e pikës nr. 2 dhe rekomandimi nr. 2.1, përsa i përket faktit të konstatuar në gjetjet e grupit auditues, ju informojmë se në Fakultetin e Ekonomisë, UT nuk ka një sektor të Prokurimeve, por bazuar në nenin nr. 56 të VKM-së nr.258, datë 19.05.2021, i ndryshuar, pika nr. 3, Administratori i fakultetit sipas Autorizimit të përvitshëm nga Administratori i Universitetit, ngre çdo vit komisionin me tre anëtarë për prokurimet me vlera të vogla për vitin buxhetor ushtrimor. Sqarojmë se hartimi i fondit limit të çdo procedure bëhet në fillim të çdo viti në regjistrin e prokurimeve me planifikimin e buxhetit sipas kërkesave të njëjësive bazë në rang fakulteti dhe më pas ky planifikim përcillet dhe vjen me ndryshimet e nevojshme me buxhetin e konsoliduar të Universitetit të Tiranës të miratuar në organet drejtuese të UT. Bazuar në pikën nr. 3, (ref aktit mësipër) të nenit nr. 13 “Studimi paraprak i tregut”, si dhe nenin nr. 56 pika 4. nene këto referuar VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021, i ndryshuar.
3. Në lidhje me gjetjet e pikës nr. 3 (3.1; 3.2) dhe rekomandimi nr. 3.1, përsa i përket faktit të konstatuar në gjetjet e grupit auditues, sikurse ju informuam dhe mësipër, në Fakultetin e Ekonomisë, UT nuk ka një sektor të Prokurimeve, por Administratori i Fakultetit sipas Autorizimit të përvitshëm nga Administratori i Universitetit, ngre çdo vit komisionin me tre anëtarë për prokurimet me vlera të vogla për vitin ushtrimor. Ju informojmë se prokurimet e realizuara në Fakultetin e Ekonomisë, janë blerje me vlera të vogla, bazuar në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, referuar VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021, i ndryshuar, për të cilat veprohet bazuar në Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, i ndryshuar me udhëzim nr. 05, datë 29.07.2022 “Për procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël”, kërkesë kjo e nenit 56, pika 6 e VKM-së, ku citohet se:” Kryerja e procedurës me mjete elektronike të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së”. Në nenin nr. 77 të VKM-së si dhe në Formularin tip nr. 2 të Udhëzimit të APP, nuk parashikohet vendosje nr. Protokolli në Urdhërin e Prokurimit por vetëm numër të urdhërit të prokurimit dhe datë. Ju informojmë se në lidhje me rekomandimin tuaj, urdhërat e prokurimeve janë me numra sipas rendit kronologjik.

Për vitin 2025 dhe në vazhdim Administratori i Fakultetit do të monitorojë rast pas rasti çdo procedurë të Komisionit të prokurimeve me vlera të vogla në lidhje me specifikimet dhe vendosjen e kriterëve për tipologjinë e objektit që prokurohet si dhe do të kërkojmë realizimin e sa më shumë trajnimeve për punonjësit që janë pjesë e këtij komisioni.

## **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Përsa i përket observimeve të paraqitura sqarojmë se:

1. Lidhur me pikën 1, pavarësisht vitit 2021, vlera e realizimit ka qëndruar pothuajse e njëjtë dhe viti 2024 ka pasur një realizim prej 74%, dmth jo rritje e konsiderueshme e realizimit të procedurave të prokurimit.
2. Lidhur me pikën 2 dhe 3, nuk ka fakte të reja, si dhe marrja në konsideratë e këtyre rekomandimeve ashtu siç ju shpreheni në observacion, mund të jetë një faktor për përmirësimin e çështjes. Ndërsa lidhur me pretendimin se FE-UT nuk ka një sektor prokurimesh, grupi i auditimit merr në konsideratë observacionin dhe e reflekton në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Përsa më sipër observacioni juaj merret në konsideratë pjesërisht.

### **2.6 Vlerësimi i funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar**

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër pika 1, nënpika 6, u auditua vlerësimi i funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli në Universitetin e Tiranës është konsideruar si një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike. Është hartuar “Rregullore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në Universitetin e Tiranës” me Vendim nr. 61, datë 16.10.2025 miratuar me Urdhrin e Brendshëm nr. 05, datë 16.04.2014. Në drejtimin të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Universitetin e Tiranës, janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimin e objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike për të gjithë komponentët.

#### ***Sipas Rregullores për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në Universitetin e Tiranës, pika 9, 21.3, 21.5 dhe 23:***

- 9.1 dhe 9.2 - Në fakultete, kancelari është nëpunësit autorizues i deleguar nga Dekani, i cili ka në varësi të drejtpërdrejtë personelin administrativ të Fakultetit;
- 9.3 - Nëpunësi Autorizues në Fakultete ka detyrimin të përgjigjet kërkesave të NA në Rektorat sa herë që kërkohet, por jo më pak se katër herë në vit, për raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuara në vitin e parë të dokumentimit përfundimtar të PBA-së;
- 9.5 - NA i Fakultetit i raporton NA të Rektoratit për statusin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet me menaxhimin të njësisë që drejtojnë;
- 9.7 - NA organizon punën për hartimin e PBA-së dhe projekt buxhetit, duke planifikuar me kujdes buxhetin e të ardhurave dhe shpenzimet e njësisë;
- 9.8 - NA i paraqet Rektoratit kërkesat e planifikuara e ato emergjente për bazën materiale mësimore e shkencore, siguron tërheqjen dhe mirëmbajtjen e tyre dhe planifikon shpërndarjen në Fakultet;
- 21.3 - Informacion për procedura për ngarkesën mësimore, sipas kërkesave ligjore me qëllim realizimin me efikasitet dhe gjurmimin e të gjithë proceseve dhe aktiviteteve të kontrollit;
- 21.5 – Rakordimet mujore të shpenzimeve, të dërguara në thesar brenda datë 5 të çdo muaji;
23. - Njësitë raportojnë periodikisht në Rektorat për përdorimin e fondeve të deleguara nga këto

të fundit. NA duhet të paraqesë në Rektorat brenda datës 15 të muajit pasardhës të çdo tre mujori, informacion të detajuar mbi performancën e produkteve të buxhetit vjetor.

### ***Në Drejtim të Informimit dhe Komunikimit***

Informimi dhe komunikimi janë konsideruar thelbësorë për zbatimin e të gjithë objektivave të kontrollit të brendshëm. Në kuadrin e ekzistencës së udhëzimeve e rregulloreve të shkruara, mbi mënyrën e komunikimit brenda institucionit (komunikimi me shkrim, elektronik ose verbal), mundësia që u jepet punonjësve nga sistemi aktual i komunikimit, marrja e informacioneve të duhura për zbatimin e detyrave të tyre, rezultoi se në Universitetin e Tiranës shkëmbimin e informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë mirë sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike, sipas rregullores së brendshme të institucionit. Drejtoria ekonomike si dhe administratori janë strukturat përgjegjëse që sigurojnë informacionin për të informuar instancat mbi shpenzimet aktuale, krahasuar me buxhetin e planifikuar në total dhe për çdo program për të cilin ata kanë përgjegjësi. Këto struktura informohen vazhdimisht nëpërmjet raportimeve nga njësitë e vartësisë gjatë veprimtarisë së përditshme dhe sa herë që kërkohet informacion mbi mbledhjet e diskutimet që zhvillohen në fakultete. Komunikimi me subjektet e jashtme përveç formës shkresore kryhet edhe në formë elektronike.

### ***Për vitin 2021***

Fakultetit Ekonomik pasi i është dërguar “Për përgatitjen e buxhetit të konsoliduar për vitin 2021” nga UT me shkresën nr. 3245 prot., datë 11.11.2020, ka hartuar dhe dërguar kërkesat:

1. Nr. 27/2 prot., datë 05.02.2021 “Për realizimin e Buxhetit financiar të vitit 2020 dhe plan 2021 të FE-UT”, bashkëlidhur analiza dhe situacioni;
2. Janë dërguar tek UT çdo muaj për akt rakordimet me degën e thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat e fakultetit;
3. Shkresa nr. 1507 prot., datë 07.06.2021 “Për përgatitjen e PBA 2022-2024” nga UT dërguar Fakultetit të Ekonomisë.

### ***Për vitin 2022***

Fakultetit Ekonomik i është dërguar “Për përgatitjen e buxhetit të konsoliduar për vitin 2022” nga UT me shkresën nr. 4135 prot., datë 03.12.2021, ka hartuar dhe dërguar kërkesat:

1. Nr. 276 prot., datë 28.02.2022 “Për realizimin e Buxhetit financiar të vitit 2021 dhe për detajimin e kuotave të Buxhetit financiar të konsoliduar të vitit 2022”, bashkëlidhur analiza dhe situacioni;
2. Janë dërguar tek UT çdo muaj për akt rakordimet me degën e thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat e fakultetit;
3. Shkresa nr. 1629 prot., datë 27.05.2022 “Për përgatitjen e PBA 2023-2025” nga UT dërguar Fakultetit të Ekonomisë.

### ***Për vitin 2023***

Fakultetit Ekonomik i është dërguar “Për përgatitjen e buxhetit të konsoliduar për vitin 2023” nga UT me shkresën nr. 3242 prot., datë 24.11.2022 dhe Vendimin e Bordit të Administratorëve nr. 02, datë 16.01.2023 me shkresë nr. 17/3 prot., datë 16.01.2023, ka hartuar dhe dërguar kërkesat:

1. Nr. 239/1 prot., datë 14.02.2023 “Përcillet realizimi i Buxhetit financiar për vitin 2022 dhe draft Buxheti financiar i konsoliduar për vitin 2023”, për Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, bashkëlidhur analiza dhe situacioni;

2. Janë dërguar tek UT çdo muaj për akt rakordimet me degën e thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat e fakultetit;
3. Shkresa nr. 1749 prot., datë 14.06.2023 “Për përgatitjen e PBA 2024-2026” nga UT dërguar Fakultetit të Ekonomisë.

#### ***Për vitin 2024***

Fakultetit Ekonomik i është dërguar “Për përgatitjen e buxhetit të konsoliduar për vitin 2024” nga UT, FE ka hartuar dhe dërguar kërkesat:

1. Nr. 150 prot., datë 31.01.2024 “Miratimin e Projekt Buxhetit Financiar të konsoliduar për vitin 2024, për Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, bashkëlidhur analiza dhe situacioni;
2. Janë dërguar tek UT çdo muaj për akt rakordimet me degën e thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat e fakultetit;
3. Shkresa nr. 1746 prot., datë 07.06.2024 “Për përgatitjen e PBA 2025-2027” nga UT dërguar Fakultetit të Ekonomisë.

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi Fakulteti Ekonomik nuk ka dërguar hartimin e PBA-së dhe projekt buxhetit në Rektorat dhe nuk ka raportuar periodikisht në Rektorat për përdorimin e fondeve të deleguara nga këto të fundit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 9.7 dhe 23 të “Rregullores për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në Universitetin e Tiranës” me Vendim nr. 61, datë 16.10.2025 miratuar me Urdhrin e Brendshëm nr. 05, datë 16.04.2014.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: z. E. H., Administrator i Fakultetit të Ekonomisë dhe znj. D. H., Përgjegjëse në Degën e Financës dhe Buxhetit.*

Sa më sipër mbajtur akt konstatimi nr. 5, datë 11.04.2025

Për sa është trajtuar në lidhje me pikën e mësipërme në Projekt Raportin e Auditimit, është paraqitur observacioni me nr. 620/7 prot., datë 31.07.2025, protokolluar në KLSH me nr. 103/34 datë 01.08.2025, nga z. E. H. me pozicion Administrator i Fakultetit të Ekonomisë, për të cilin japim sqarimet si më poshtë.

#### **Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me gjetjet e pikës nr. 4 dhe rekomandimi nr. 4.1, përsa i përket faktit të konstatuar në gjetjet e grupit auditues, Fakulteti i Ekonomisë është pjesë përbërëse e Universiteti të Tiranës. Bazuar në Ligjin 80/2015. Universiteti i Tiranës është Institucioni i Arsimit të Lartë ndërsa Fakulteti është njësi kryesore, ndaj dhe informimi dhe komunikimi është organik i brendshëm dhe jo si ndërmjet dy institucioneve. PBA, dërgohet pranë Rektoratit të UT, në formën sipas kërkesave të Rektortit elektronikisht dhe në me shkresë zyrtare. Përdorimi i fondeve nga fakulteti është i monitoruar online nga Rektorati i UT. Mbarëvajtja ndërmjet Fakultetit dhe Rektoratit të UT, në lidhje me projekt buxhetet ka qenë tejet rezultativ dhe pozitiv nga ana e fakultetit si njësi shpenzuese pranë Institucionit qëndror të arsimit të lartë të UT.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Përsa i përket observimeve të paraqitura për PBA-në e cila nuk është dërguar në UT, sqarojmë se kjo kërkesë është përcaktuar në pikën 9.7 dhe 23 të “Rregullores për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në Universitetin e Tiranës” me Vendim nr. 61, datë 16.10.2025 miratuar me Urdhrin e Brendshëm nr. 05, datë 16.04.2014. Përsa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

## **2.7 Vlerësimi i komponentëve të auditimit të brendshëm**

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër pika 1, nënpika 7, u auditua vlerësimi i komponentëve të auditit të brendshëm.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në UT është pjesë e strukturës administrative të Rektoratit të Universitetit të Tiranës (UT), por është funksionalisht i pavarur dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Bordi i Administrimit të Universitetit. Në UT ka qenë në fuqi struktura organizative e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Rektoratin e UT sipas vendimit të Bordit të Administrimit të UT me nr. 39 datë 04.04.2018 dhe është i pandryshuar deri në vitin raportues. Sa më sipër rezulton se në Fakultetin e Ekonomisë nuk ka strukturë të Auditit të Brendshëm.

Në këto kushte për subjektin e auditimit u vijua mbi auditimet e kryera nga Universiteti i Tiranës, Bordi i Administrimit, Drejtoria e Auditit të Brendshëm me programin nr. 1678/1 prot., datë 07.06.2022, për periudhën 01.01.2019-31.12.2021. Është hartuar Projektraporti dhe është dërguar me shkresën nr. 1678/3 prot., datë 28.09.2022, duke vijuar me Raportin Përfundimtar dërguar me shkresën nr. 1678/3 prot., datë 25.11.2022. Nga Fakulteti Ekonomik janë marrë masa për të hartuar planin e veprimit me shkresë nr. 756/3 prot., datë 28.12.2022, ku shprehen për pranimin e masave dhe caktimin e strukturës përgjegjëse për ndjekjen e rekomandimit.

Gjithashtu, është kryer edhe auditim tematik për zbatimin e rekomandimeve nga UT dhe është dërguar me shkresë nr. 1678/7 prot., datë 13.04.2023 “Për përcjelljen e Raportit për zbatimin e rekomandimeve”, ku rezulton se nga 3 rekomandime, është zbatuar 1 prej tyre, 1 rekomandim është në proces dhe 1 rekomandim është i pa zbatuar.

## **III. GJETJE DHE REKOMANDIME**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, u konstatua mangësi në procesin e planifikimit të procedurave nga numri i procedurave të realizuara mesatarisht me 73%, si rezultat i mosplanifikimit real të nevojave institucional, veprime në kundërshtim me Kreun II, neni 3, pika 2, VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe pikës 1 të Udhëzimit nr. 04, datë 18.6.2021, të APP-së “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimit të tyre në SPE”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 44-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Administratori i Fakultetit të Ekonomisë, të marrë masat e nevojshme për planifikimin me real të procedurave të prokurimit, me qëllim përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave institucional.

*Në vijimësi*

**2. Gjetja nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave me vlerë të vogël për periudhën objekt auditimi, rezultoi se:

- Në 5 (pesë) procedura përlllogaritja e fondit limit nuk është bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet, në kundërshtim me nenin 76, pika 2 e VKM nr.258, datë 19.05.2021, e ndryshuar.
- Për 3 (tre) procedura, shërbimi ka filluar realizimin e tij dhe është bërë marrja në dorëzim nga grupi i ngritur nga titullari i AK para realizimit me sukses në SPE të procedurës, në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 të ndryshuar, neni 96.

*(Më hollësisht trajtuar pikën 2.5, faqe 44-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Administratori i Fakultetit Ekonomik të marrë masat e nevojshme në hartimin e fondit limit, specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve në përputhje me tipologjinë e objektit që prokurohet.

*Në vijimësi*

### **3. Gjetja nga auditimi:**

**3.1** Nga auditimi i procedurat të prokurimit për vitin 2021 dhe 2024 u konstatua se nga AK nuk janë hartuar kërkesë paraprake për fillimin e procedurës së prokurimit, veprime në kundërshtim me nenin 2 pika 2 germa “a” dhe nenin 13 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**3.2** Nga auditimi i dokumentacionit për procedurat e prokurimit, rezultoi se këto procedura në të gjitha rastet nuk ishin të inventarizuara e për pasojë të arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe nenit 21 “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”. Referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Veprimtaria e Kontrollit. *(Më hollësisht trajtuar pikën 2.5, faqe 44-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Fakulteti i Ekonomisë, personat përgjegjës për prokurimet të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e të gjithë procedurave, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, në zbatim të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

*Në vijimësi*

**4. Gjetja nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi Fakulteti Ekonomik nuk ka dërguar hartimin e PBA-së, projekt buxhetit dhe nuk ka raportuar periodikisht në Rektorat për përdorimin e fondeve të deleguara nga këto të fundit, duke sjellë moskomunikim dhe informim me institucionet eprorë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 9.7 dhe 23 të “Rregullores për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në Universitetin e Tiranës” me Vendim nr. 61, datë 16.10.2025 miratuar me Urdhrin e Brendshëm nr. 05, datë 16.04.2014”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 52-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Administratori i Fakultetit Ekonomik të marrë masat në vijimësi, që pas përgatitjes së PBA-së, ta dërgojë atë në Rektorat në mënyrë zyrtare, si dhe të raportojë periodikisht për përdorimin e fondeve të deleguara nga këto të fundit, në mënyrë që të ketë një mbarëvajtje, informim dhe komunikim midis dy institucioneve.

*Në vijimësi*

**5. Gjetja nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i urdhër-shpenzimeve, u konstatua mosrespektim i afateve, sa i takon likuidimit të faturave, konkretisht për vitin 2022 janë evidentuar 9 raste dhe për vitin 2023 dy raste, nga 140 të testuara nga auditimi, duke tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pika 184, si dhe Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 11-17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandim:** Sektori i Financës të marrë masat të paraqesë në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

*Në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me përzgjedhje i formularëve të planifikimit, shpërndarjes së ngarkesave dhe mbingarkesave në Fakultetin e Ekonomik, në formularin e planifikimit, pasqyroheshin të dhënat nga “veprimtaria mësimdhënëse” e detajuar të personelit akademik, programet e studimit, lëndët mësimore sipas planeve të miratuara, orët e specifikuara. Ndërsa veprimtaria tjetër “kërkimi shkencor”, “kontributi institucional” dhe “kontributi profesional” nuk raportohet e detajuar, veprime në kundërshtim të Udhëzimit nr.29 datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 17-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Në formularët e planifikimit, shpërndarjes së ngarkesave dhe mbingarkesave për “kërkimi shkencor” të specifikohet kërkimi ose veprimtaria kërkuese, pjesëmarrja në programet kërkimore. Për “kontributin institucional” të specifikohen hartimi i programeve të studimit, i rregulloreve, botimet universitare, pjesëmarrja në komisione dhe në organet e njësisë bazë. Për “kontributin profesional” të specifikohen ekspertizat, përhapja e njohurive shkencore e teknologjike në mbështetje të mësimdhënies.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me përzgjedhje i urdhër shpenzimeve lidhur me pagesat e personelit akademik me kohë të pjesshme, u konstatua se deklarimi i punonjësve/stafit në organet tatimore bëhej në momentin e likuidimit në fund të periudhës mësimore, veprime në kundërshtim të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 17-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa për deklarimin e punonjësve në organet tatimore, një ditë përpara fillimit të ofrimit të shërbimit nga ana e punonjësve, si dhe të bëhet trajnimi i stafit lidhur me ndryshimet ligjore sa i përket legjislacionit të marrëdhënies të punës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarive të arkëtueshme, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” përfaqëson detyrimet që kanë të tretët ndaj fakultetit e cila për periudhën e auditimit është mbyllur me tepriçë zero. Nga të dhënat e marra nga dega e shërbimeve të fakultetit konstatohen se për periudhën 2021 – 2024 janë 1,227 studentë debitorë me vlerë totale 85,834,100 lekë. Në librat e kontabilitetit të fakultetit këto të dhëna nuk janë konstatuar apo kontabilizuar, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 25-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Fakultetit të Ekonomisë, të marrë masa për identifikimin dhe verifikimin e plotë të debitorëve (studentëve me detyrime financiare të papaguara), për periudhën 2021–2024 me qëllim regjistrimin dhe kontabilizimin e detyrimeve në pasqyrat financiare, duke siguruar rritjen e transparencës, si dhe përmirësimin e menaxhimit të të ardhurave të institucionit.

*Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione”; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 218 “Inventar ekonomik” u konstatua se

metoda e llogaritjes së amortizimit vjetor është me “Vlerë të mbetur”, si dhe norma amortizimi për periudhën objekt auditimi është e ndryshme nga viti në vit dhe jo sipas përcaktimeve të pikës 36 të Udhëzimit, përkatësisht:

Për llogarinë 212 është aplikuar 2%, dhe jo 5%; për llogarinë 214 norma e amortizimi është aplikuar 12% për vitet 2021 dhe 2022 dhe 25% për vitin 2023 dhe 2024, si dhe për llogarinë 218 është aplikuar norma 5% për vitet 2021 dhe 2022.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar pikën 2.4 faqe 25-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 Rekomandimi:** Sektori i financës të marrë masa menjëherë për rillogaritjen e vlerave të amortizimit bazuar në normat e përcaktuara për secilën klasë, përdorimin e teknikave të sakta kontabël për regjistrimin e daljes jashtë përdorimi të aseteve. Rezultatet e përllogaritjeve të pasqyrohen në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2025, duke bërë që llogaritë e aktiveve afatgjata materiale të paraqiten në vlera të drejta dhe të rakorduara sipas kërkesave të teknikave kontabël.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të ardhurat dytësore të pasqyruara në pasqyrën e performancës u konstatua se ka mospërputhje me të dhënat e thesarit në lidhje me këto të ardhura, konkretisht: Për vitin 2024 kemi një mospërputhje në shumën 51,499,306 lekë, për vitin 2023 kemi një mospërputhje në shumën 23,845,458 lekë dhe për vitin 2022 kemi një mospërputhje në shumën 77,109,771 lekë, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të strukturës së të ardhurave. Veprime në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 25-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa të menjëhershme të mbledhë dhe të rakordojë të dhënat financiare për mbylljen e pasqyrave financiare me të gjitha institucionet me të cilat ndërvepron për veprimet financiare, për një paraqitje të plotë, të drejtë të pozicionit financiar për periudhën kontabël.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i shpenzimet për mallra dhe shërbime për vitin 2024 në nënlllogarinë 6029 “Shpenzime të tjera operative” konstatohen keqklasifikime si:

- Shpenzimet për grupin e punës për pjesëmarrjen në komisionin e përhershëm të dhënies së gradës "Doktor" në shumën 367,984 lekë vlerë e cila duhet të ishte kontabilizuar në nënlllogarinë 6009 “Shpenzime të tjera për personelin”.

- Shpenzimet “Pagesë për shërbime blerje antivirus, për Fakultetin e Ekonomisë” në shumën 119,724 lekë, vlerë e cila duhet të ishte kontabilizuar në llogarinë 203 “Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme”.

- Gjithashtu nga auditimi i shpenzimeve për “Blerje mallra e shërbime” u konstatua keqklasifikime brenda nënllogarive të kësaj klase, duke sjellë një denatyrim të shpenzimeve për mallra dhe shërbime. Sa më sipër veprime në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 25-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi për të pasqyruar saktë shpenzimet e kryera sipas rregullave kontabël, natyrës së shpenzimeve, klasifikimit të saktë të tyre me qëllim paraqitjen e drejtë ne pasqyrat financiare.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të inventarizimit për periudhën objekt auditimit u konstatua se, nga grupi i inventarizimit nuk është hartuar raport lidhur me procesin e inventarizimit, si dhe nuk është kryer inventarizimi i të gjithë aktive të pasqyruara dhe kontabilizuar në librat kontabël.

Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” si dhe Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 25-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1 Rekomandimi:** Administratori i fakultetit të marrë masa në vijimësi që procesi i inventarizimit të realizohet i plotë, si dhe të dokumentohen të gjitha fazat e këtij procesi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.*

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**